

Përmbaju ose Mbyll

Gjashtë vjet shkelje ligjore vdekjeprurëse nga termocentralet e qymyrit të Ballkanit Perëndimor

Përditësimi i vitit 2024



Ky botim është financuar nga Bashkimi Evropian. Megjithatë, pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm të autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e Bashkimit Evropian ose CINEA. As Bashkimi Evropian dhe as subjekti grantues nuk mund të mbahen përgjegjës për to.



Sweden
Sverige

Ky publikim është financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim, Sida. Përgjegjësia për përmbajtjen i takon tërësisht krijuesit. Sida nuk ndan domosdoshmërisht pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

Hulumtuar dhe hartuar nga:

Joana Ciuta, Rrjeti Bankwatch për Evropën Qendrore dhe Lindore / CEE Bankwatch Network

Pipa Gallop, Rrjeti Bankwatch për Evropën Qendrore dhe Lindore / CEE Bankwatch Network

Davor Pehçevski, Rrjeti Bankwatch për Evropën Qendrore dhe Lindore / CEE Bankwatch Network

Mirënjohje:

Diana Milev-Çavor, Eco-Team

Elena Nikollovska, Eko-Svest

Kristina Dimitrova, Rrjeti Bankwatch për Evropën Qendrore dhe Lindore / CEE Bankwatch Network

Rexhib Skomorac, Qendra për Mjedis Jetësor / Center for Environment

Hristina Vojvodić, Renewables and Environmental Regulatory Institute (RERI)

Redaktoi:

Emili Grej, Rrjeti Bankwatch për Evropën Qendrore dhe Lindore / CEE Bankwatch Network

Foto e kopertinës:

Përpara: Termocentralet Kakanj, Bosnja e Hercegovina, Arnika/Martin Plocek

Mbrapa: Termocentralet Gacko, Bosnja e Hercegovina, Andrey Ralev

Disenjoi:

Millan Triviq

Ky raport është mbështetur nga organizatat e mëposhtme:



Përmbajtja

Fjalorth i termave	5
Përmbledhje e përgjithshme	6
Hyrje	9
Pasqyrë rajonale e emetimeve të ndotësve	10
Paqartësitë e NECP për ndalimin e qymyrit	16
Profilet e shteteve	17
Bosnja e Hercegovina	17
Kosova	24
Mali i Zi	28
Maqedonia e Veriut	32
Serbia	36
Konkluzë dhe rekomandime	41
Shtojca 1: Materiale dhe metodologjia	44

Përmbajë ose Mbyll **2024**

Gjashtë vjet shkelje ligjore vdekjeprurëse nga termocentralet e qymyrit të Ballkanit Perëndimor

www.complyorclose.org

Fjalorth i termave

CBAM – Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit. Ky instrument synon të përcaktojë një çmim të drejtë për karbonin e emetuar gjatë prodhimit të produkteve nga sektorë të caktuar të cilat eksportohen në BE, përfshirë këtu edhe energjinë elektrike, dhe të inkurajojë një prodhim industrial më të pastër në vendet jashtë BE. Faza e saj tranzicionale filloi në vitin 2023 dhe nga 1 janari 2026 do të aplikohen tarifat për importin e mallrave në BE.

De-NO_x – Pajisjet për zvogëlimin e emetimeve të oksideve të azotit.

De-SO_x – Pajisjet e desulfurizimit.

ELV – Vlera Kufitare e Emetimeve. Kjo përfaqëson sasinë e lejuar të një lënde që përmbahet në gazrat e mbetura nga termocentrali i djegies, të cilat mund të shkarkohen në ajër gjatë një periudhe të caktuar; llogaritet masa e vëllimit të gazrave të mbetura, e shprehur në mg/Nm³.

Energy Community Treaty – Traktati i Komunitetit Energjetik, i nënshkruar në vitin 2005, i cili hyri në fuqi në vitin 2006 dhe synon të zgjerojë tregun energjetik të BE në fqinjësinë e tij më të afërt, duke zbatuar legjislacionin energjetik, mjedisor dhe të konkurrencës së BE në sektorët e tyre energjetikë. Traktati aktualisht përfshin Bashkimin Evropian, Shqipërinë, Bosnjë e Hercegovinën, Gjeorgjinë, Kosovën, Moldavinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Ukrainën.

BE – Bashkimi Evropian

IED – Direktiva e Emetimeve Industriale – Direktiva 2010/75/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, nga 24 nëntori 2010, mbi emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes).

LCP – termocentral i madh me djegie të brendshme. Ky përkufizohet si një tërësi pajisjesh teknike që përdoren për oksidimin e karburantit, duke shfrytëzuar nxehësinë e gjeneruar me një input termik të vlerësuar, të barabartë ose më të madh se 50 megavat (MW). Këtu përfshihen termocentralet të tilla si termocentralet me karburante fosile ose me djegie bio-mase dhe me djegie të brendshme në rafineri naftë.

LCP BREF – Dokumenti referues i teknikave më të mira të disponueshme për termocentralet e mëdha me djegie të brendshme, konkluzat e të cilit u bënë ligjërues të detyrueshme me Vendimin Zbatues të Komisionit (BE) 2017/1442 të datës 31 korrik 2017, që përfshin konkluzat e teknikave më të mira të disponueshme (BAT) dhe – pas një kontesti ligjor mbi baza procedurale – përsëri u rikonfirmuan në Vendimin Zbatues të Komisionit (BE) 2021/2326 të datës 30 nëntor 2021 për përfshirjen e konkluzave për teknikat më të mira të disponueshme (BAT), sipas Direktivës 2010/75/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për termocentralet e mëdha me djegie të brendshme (të njoftuar me dokumentin C (2021) 8580).

LCPD – Direktiva për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme – Direktiva 2001/80/EC mbi kufizimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga termocentralet e mëdha me djegie të brendshme.

MWe – megavat energji elektrike – forma më e zakonshme e shprehjes së kapacitetit të një termocentrali.

MWth – inputi i vlerësuar termik i përgjithshëm i një termocentrali – vlerësimi i përdorur në legjislacionin e BE për të përcaktuar kategori të ndryshme të madhësive të termocentraleve. Në përgjithësi, është më e vështirë të arrihen përqendrime më të ulëta të emetimeve nga termocentralet më të vogla, kështu që kufijtë e ndotjes kategorizohen sipas madhësisë së tyre.

NERP – Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emetimeve – një mekanizëm fleksibil zbatimi sipas Direktivës për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme në Komunitetin Energjetik, ku emetimet mund të zvogëlohen gradualisht duke marrë totalin e emetimeve të tyre së bashku dhe duke siguruar që ato janë më të ulëta se kufijtë maksimalë në ulje, të përcaktuara për vitet 2018, 2023, 2026 dhe 2027.

NO_x – oksidet e azotit.

Opt-out – një mekanizëm fleksibil zbatimi sipas Direktivës për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme, ku termocentralet mund të vonojnë investimet në pajisjet e kontrollit të ndotjes për sa kohë që ato kufizojnë funksionimin e tyre në 20 000 orë pune nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2023. Çdo termocentral që operon pas këtyre orëve duhet të jetë në përputhje me rregullat për vlerat e lejuara të emetimeve nga termocentralet e reja, jo ato ekzistuese.

PM ose pluhur – grimca pluhuri.

SO₂ – dioksid sulfurik.

Përmbledhje e përgjithshme

Fundi i vitit 2023 shënoi gjashtë vite nga skadimi i afatit që termocentralet në Ballkanin Perëndimor të përmbajnë standardet e reja të ndotjes së ajrit. Megjithatë, ndotja vdekjeprurëse e ajrit nga termocentralet kryesisht të vjetëruara të qymyrit në rajon, pothuajse nuk është ulur fare. Në fakt, në vitin 2023 ndotja nga dioksidi sulfurik (SO₂) shënoi rritje në krahasim me vitin 2022, ndërsa emetimet e pluhurit dhe oksideve të azotit (NO_x) mbetën në nivele të larta.

Në vitin 2023, emetimet e përgjithshme të SO₂ nga termocentralet e përfshira në Planet Kombëtare të Zvogëlimit të Emisioneve (NERP)¹ të Bosnjë e Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë ishin 5,7 herë më shumë nga vlera maksimale e lejuar – më të larta se në vitin 2022 dhe vetëm pak më të ulëte se emetimet vjetore nga periudha 2018-2020, kur ishin gjashtë herë më shumë nga vlera e lejuar.

Emetimet e pluhurit shënuan ulje të vogël në vitin 2023 dhe ishin gati 1,75 herë më të larta nga vlerat që parashihnin NERP e vendeve përkatëse, krahasuar me 1,8 herë në vitin 2022. Kosova, Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut përsëri tejkaluan dukshëm kufijtë e tyre kombëtarë për emetimin e pluhurit.

Emetimet e përgjithshme të oksideve të azotit nga termocentralet e përfshira në NERP arritën gjithashtu në 1,3 herë më shumë nga vlerat maksimale të lejuara, për shkak të mungesës së investimeve për zvogëlimin e NO_x dhe uljes vjetore të kufijve maksimalë për NO_x të parapara me NERP përkatës. Kosova dhe Bosnja e Hercegovina edhe një herë tejkaluan kufijtë e tyre, por kësaj radhe atyre iu bashkua Serbia. Kosova kishte tejkalimin më të lartë, me 2,73 herë më shumë se kufiri i saj kombëtar.

Në vitin 2023, termocentralet e qymyrit të parapara me NERP-in e Serbisë ishin përsëri emetuesit më të lartë të SO₂ në terma absolutë, me 296 011 tonë, ndjekur nga Bosnja e Hercegovina me 181 807 tonë. Emetimet e SO₂ të termocentraleve të Serbisë në krahasim me vitin 2022 shënuan rritje, ndërsa ato të Bosnjës e Hercegovinës qëndruan pothuajse të njëjta.

Pavarësisht se në nëntor të vitit 2021 shkelësi i vjetër Ugljevik në Bosnjë e Hercegovinë kishte marrë një leje operimi për njësinë e saj të desulfurizimit (de-SO_x) që kishte kushtuar 85 milionë euro,² ky impiant në vitin 2023 emetoi sasinë më të lartë absolute të SO₂ – 97 189 tonë. Kjo paraqet rritje krahasuar me një vit më parë. Operatori pranon se desulfurizimi kryesisht nuk funksionon sepse është një 'barrë ekonomike', por edhe për shkak të mungesës së objekteve të depozitimit të gipsit që rezultojnë nga procesi.

Edhe pse të detyrueshme janë vetëm vlerat kufitare në nivel vendi, duke parë tejkalimet e kufijve tregues për njësitë individuale nënkuptohet se ku nevojiten intervenime të veçanta. Në vitin 2023, së paku katër termocentralet tejkaluan kufijtë e tyre për emetimet e SO₂ për më shumë se 10 herë: Ugljevik dhe Kakanj 7 në Bosnjë e Hercegovinë, Bitola 1 & 2 në Manastir të Maqedonisë së Veriut dhe Kostolac A2 në Serbi.

Kostolac B, një nga emetuesit më të lartë të SO₂ nga viti 2018 deri në vitin 2020, më në fund filloi të ulë emetimet e tij në vitin 2021 gjatë testimit të pajisjeve të desulfurizimit, por i rriti ato përsëri në vitet vijuese 2022 dhe 2023, duke emetuar gati 5,8 herë më shumë nga vlerat e përcaktuara ato dy vite. Ky nivel ende është më i ulët se emetimet nga viti 2018 deri në vitin 2020, mirëpo ose njësia de-SO_x nuk përdoret rregullisht ose nuk funksionon mirë.

Emituesi më i lartë absolut i pluhurit në rajon në vitin 2023 ishte Kosova B2 në Kosovë, e cila emetoi 3 798 tonë – një rritje e madhe nga 2 517 tonë në vitin 2022, dhe 9,2 herë më shumë nga vlerat maksimale të parapara me NERP e Kosovës.

Termocentrali Gacko në Bosnjë e Hercegovinë kishte tejkalimin më të lartë relativ të pluhurit, duke emetuar pothuajse 10,7 herë më shumë nga vlera e lejuar, ose 3 241 tonë. Kjo përfaqëson një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2022, kur emetoi 3 649 tonë. Në fund të vitit 2023 u raportuan ulje të ndotjes nga pluhuri, por tendenca ishte tepër e vonuar për të reflektuar me përmirësime të konsiderueshme në të dhënat e emetimeve për vitin aktual.

¹ Si pjesë e detyrimeve të tyre

për të respektuar Direktivën për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme sipas Traktatit të Komunitetit Energjetik, katër vende të Ballkanit Perëndimor – Bosnja e Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia – kanë hartuar Planet Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve (NERP) që mbulojnë periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2027. Në vend që të kërkohet që çdo termocentral i madh me djegie të brendshme të jetë në përputhje me vlerat kufitare të emetimeve nga Direktiva për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme, e miratuar më 1 janar 2018, këto plane u lejojnë vendeve të llogarisin kufijtë kombëtarë të emetimeve të dioksidit sulfurik, oksidit të azotit dhe pluhurit, dhe gradualisht deri në vitin 2027 të zvogëlojnë emetimet e tyre të përgjithshme nga termocentralet e përzgjedhura të mëdha me djegie të brendshme të ndërtuara para vitit 1992. Në vitin 2027 të gjitha termocentralet e përfshira në NERP, individualisht do të duhet të jenë në përputhje jo vetëm me vlerat kufitare të emetimeve nga Direktiva e Termocentraleve të Mëdha me Djegie të Brendshme, por edhe me Pjesën 1 të Aneksit V të Direktivës 2010/75/BE për Emetimet Industriale.

² Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimeve dhe Mjedisit Jetësor e Republika Sërpëskës, [Decision no. 15.03-360-164/21](#), 11 nëntor 2021.

Në vitin 2023 emetimet më të larta absolute të oksideve të azotit i kishte Nikola Tesla B në Serbi, me 11 633 tonë – një rritje e konsiderueshme nga 8 500 tonë në vitin 2022.

Në terma relativë, në vitin 2023 Kosova A4 ishte shkelësi më i keq sa i përket emetimeve të oksideve të azotit, duke emetuar 4,2 herë më shumë nga vlerat e lejuara, ose 2 761 tonë.

Në korrik të vitit 2023, Sekretariati i Komunitetit Energjetik ndërmori hapa të mëtijshëm në procedurën e zgjidhjes së kontesteve që inicioi kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë për shkeljet e tyre të vlerave të parapara me NERP për vitin 2021, duke i parashtruar një kërkesë të arsyeshme Këshillit të Ministrave të Komunitetit Energjetik për të marrë vendime mbi rastet,³ gjë që u bë në dhjetor të vitit 2023.⁴ Çështja kundër Serbisë mbetet e hapur, por nuk është ngritur në instancë më të lartë për shkak të investimeve aktuale.

Përveç shkeljeve të NERP, në fund të vitit 2023 skadoi afati për mbylljen e termocentraleve që i ishin nënshtruar një regjimi të afatizuar funksionimi. Të tre vendet e Ballkanit Perëndimor me termocentrale me qymyr që i nënshtrohen kësaj dispozite – Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia – tani po e shkelin atë, pasi asnjë prej termocentraleve nuk ka pushuar së funksionuari. Në vitin 2023 këto termocentrale kontribuan në ndotjen masive të rajonit me qymyr, por nuk janë pjesë e statistikave të nxjerra nga NERP më sipër.

Termocentrali Pljevlja në Malin e Zi ka funksionuar ilegalisht që nga fundi i vitit 2020, kur vazhdoi të operojë përtej 20 000 orëve të lejuara pas 1 janarit 2018. Por në vitin 2022, Malit të Zi iu bashkuan fillimisht Tuzla 4 dhe Kakanj 5 të Bosnjë e Hercegovinës dhe më pas edhe termocentrali Morava i Serbisë. Operatori i Moravës, Elektroprivreda Srbije (EPS), ka deklaruar se do të vazhdojë të operojë deri në vitin 2026, së bashku me një tjetër termocentral që është nën këtë regjim, Kolubara A.

Siç paraqiti botimi i vitit 2021 i “Përmbajje ose Mbyll”, shkelje të tilla nuk janë vetëm një çështje ligjore, por çështje jete a vdekjeje. Nga numri i përgjithshëm prej 19 000 vdekjesh, të shkaktuara nga termocentralet e qymyrit të Ballkanit Perëndimor nga viti 2018 deri në vitin 2020, numri i vdekjeve të shkaktuara nga tejkallimet e vlerave maksimale të parapara me NERP gjatë kësaj periudhe ishte gati 12 000.

Për shkak të shkeljeve të dispozitave për ndalim funksionimi, Sekretariati i Komunitetit Energjetik në prill të vitit 2021 hapi raste gjyqësore kundër Malit të Zi,⁵ në tetor të vitit 2022 kundër Bosnjë e Hercegovinës⁶ dhe në tetor të vitit 2023 kundër Serbisë.⁷

Gati gjashtë vjet pas kalimit të afatit për harmonizim me LCPD e Komunitetit Energjetik, situata mbetet e tmerrshme. Që nga viti 2018 emetimet e dioksidit sulfurik dhe oksideve të azotit të përcaktuara me NERP mezi janë ulur, e madje për pluhurin kanë shënuar rritje. Asnjë nga termocentralet e afatizuara për funksionim nuk është mbyllur.

Shkelje edhe më të mëdha mund të ndodhin këtë vit, për shkak të uljes së vlerave maksimale të parapara me NERP për të tre ndotësit e matur. I vetmi faktor i mundshëm lehtësues është njësia e desulfurizimit, e cila u hap në termocentralin Nikola Tesla A në Serbi këtë prill.⁸ Por, siç shihet në rastin e Ugljevik ose Kostolac B, suksesi i saj varet nëse me të vërtetë vihet në përdorim.

Asnjë nga vendet nuk duket se ka një plan të qartë, të përditësuar dhe realist për të siguruar harmonizim dhe/ose mbylljen e të gjitha termocentraleve të tyre me qymyr. Madje edhe Maqedonia e Veriut, një lider rajonal për sa i përket instalimeve solare, devijon nga Plani i saj Kombëta për Energji dhe Klimë (NECP), duke u shpërqendruar nga planet e kushtueshme të energjisë së gazit dhe duke shtyrë afatin e heqjes së qymyrit nga përdorimi prej vitit 2027 në vitin 2030, dhe nuk bën pothuajse asgjë për të trajtuar ndotjen.

Bosnja e Hercegovina, Kosova dhe Serbia humbën afatin e qershorit 2024 për të paraqitur NECP e tyre përfundimtare në Sekretariatit e Komunitetit Energjetik dhe draftet e dorëzuara dhanë vetëm disa të dhëna rreth planeve të tyre për heqjen e qymyrit nga përdorimi.⁹ EPS i Serbisë ka qenë më konkret në lidhje me planet e tij deri në vitin 2028, por jo më tej. Mali i Zi madje nuk ka publikuar as edhe draftin e parë të NECP.

Në përgjithësi, nivelet e ndotjes gjashtë vjet pas afatit për zbatimin e Direktivës për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme në Ballkanin Perëndimor janë krejtësisht skandaloze. Qeveritë e Ballkanit Perëndimor më në fund duhet të fillojnë të qeverisin dhe të mos lejojnë që kompanitë energjetike të zgjasin pafundësisht afatet e tyre.

³ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Case ECS-08/21](#), Energy Community, së fundmi lexuar më 5 korrik 2024.

⁴ Këshilli i Ministrave i Komunitetit Energjetik, [Decision 2023/04/MC-EnC on the failure by the Republic of North Macedonia to comply with the Energy Community Treaty in Case ECS-7/21](#), [Decision 2023/05/MC-EnC on the failure by Kosovo* to comply with the Energy Community Treaty in Case ECS-8/21](#) dhe [Decision 2023/06/MC-EnC on the failure by Bosnia and Herzegovina to comply with the Energy Community Treaty in Case ECS-9/21](#), 14 dhjetor 2023.

⁵ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [‘Secretariat launches dispute settlement procedure against Montenegro for breaching Large Combustion Plants Directive as TPP Pljevlja exhausts ‘opt-out’](#), Energy Community, 20 prill 2021.

⁶ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [‘Secretariat launches dispute settlement procedure against Bosnia and Herzegovina for breaching Large Combustion Plants Directive in the case of Tuzla 4 and Kakanj 5’](#), Energy Community, 28 tetor 2022.

⁷ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [‘Secretariat launches dispute settlement procedure against Serbia for breaching the Large Combustion Plants Directive in the case of TPP Morava’](#), Energy Community, 23 tetor 2023.

⁸ Igor Todorović, [‘Mitsubishi Power commissions desulfurization system in Serbia’s TENT A coal plant’](#), Balkan Green Energy News, 25 prill 2024.

⁹ NECP i Serbisë u miratua në fund të korrikut 2024, por deri më 29 korrik versioni final ende nuk ishte në dispozicion të publikut.

Nevoja për të ulur ndotjen dhe për të rritur efikasitetin energjetik dhe format e qëndrueshme të energjisë së rinovueshme është më e madhe se kurrë.

Detyrimet që janë marr përsipër duhet të respektohen dhe termocentralet që funksiononin nën regjimin e afatizuar duhet të mbyllen menjëherë.¹⁰ Maqedonia e Veriut duhet të shmangë vonesat e mëtejshme lidhur me datën e heqjes së qymyrit nga përdorimi dhe të dyfishojë përpjekjet për të qenë gati për të.

Njësitë e desulfurizimit të Ugljevik dhe Kostolac B duhet të operojnë sa herë që termocentralet janë në funksion. Investimet aktuale në pajisjet e desulfurizimit, denitrifikimit dhe kontrollit të pluhurit gjithashtu duhet të përshejtohen në ato pak raste kur ato kanë kosto të arsyeshme dhe shpejtë shpagohen, e në ndërkohë duhet të zvogëlohen orët e punës për të ulur barrën e ndotjes.

NECP-të duhet të përmbajnë plane realiste për termocentralet tjera në vitet e ardhshme, bazuar në gjendjen e tyre reale teknike, nivelin e investimeve të nevojshme për t'i sjellë ato në përputhshmëri të plotë dhe disponueshmërinë e linjitit me cilësi të arsyeshme. Gjithashtu duhet të merren parasysh efektet e Mekanizmit të Rregullimit të Kufirit të Karbonit, sepse ato do të ndikojnë në funksionimin e termocentraleve të qymyrit, veçanërisht në Bosnjë e Hercegovinë, Mal të Zi dhe në Maqedoninë e Veriut.¹¹

Ndërkohë, orët e tyre të operimit duhet të zvogëlohen për të mbajtur nivelet e ndotjes në minimum. Gjithashtu kërkesa energjetike mund të ulet me masa tjera, duke zvogëluar humbjet në shpërndarje, me izolimin e ndërtesave dhe instalimin e pompave efikase të nxehtësisë për ngrohje në vend të ngrohësve me energji elektrike.

Megjithëse përgjegjësia kryesore bie mbi qeveritë e Ballkanit Perëndimor, Bashkimi Evropian duhet të përdorë ndikimin e tij të rëndësishëm për të dërguar mesazhe më të qarta dhe më të fuqishme mbi nevojën për një tranzicion të qëndrueshëm dhe të drejtë të energji të ripërtitshme. BE duhet të vazhdojë mbështetjen financiare si dhe të sigurojë fonde shtesë për tranzicionin e drejtë të rajoneve të qymyrit. Edhe Traktati i Komunitetit Energjetik duhet të përforcohet me instrumente më të fuqishme zbatimi, në dobi të shëndetit të njeriut dhe mjedisit jetësor, duke forcuar mekanizmin e zgjidhjes së kontesteve me sanksione bindëse për shkeljet e bëra. Poashtu në mënyrë rigorozë duhet të zbatohet përjashtimet nga Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit (CBAM), në mënyrë që të maksimalizojë efektin e tij nxitës për tranzicion.

¹⁰ Opcioni tjetër është që të ndërmerren rekonstruime të mëdha në mënyrë që të harmonizohen me vlerat kufizuese të emetimit që kanë termocentralet e reja, sipas Traktatit të Komunitetit Energjetik, ashtu siç përpiqet të bëjë termocentrali Pljevlja, por jemi skeptik se në shumicën e rasteve kjo do të ketë arsyeshmëri ekonomike.

¹¹ Rrjeti Bankwatch për EQL, [The Western Balkan Power Sector - Between crisis and transition](#), CEE Bankwatch Network, dhjetor 2022.

Termocentralet Bitola, Maqedoni e Veriut
Foto: CEE Bankwatch Network

Hyrje

Meqenëse afati i zbatimit i Direktivës për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme (LCPD) në kuadër të Traktatit të Komunitetit Energjetik skadoi më 31 dhjetor 2017, ne kemi analizuar harmonizimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor me Planet e tyre Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve (NERP) në pesë botime të raportit “Përmbaju ose Mbyll”. Këtë vit, ne shikojmë mospërputhje të vitit 2023 krahasuar me pesë vitet e mëparshme.

LCPD u përfshi në Traktatin e Komunitetit Energjetik në vitin 2005, kur edhe u nënshkrua. Për një traktat, qëllimi i të cilit është të hapë dhe unifikojë tregun energjetik të BE me atë të fqinjëve të saj të afërt në Evropën Juglindore dhe Lindore, përfshirja e legjislacionit mjedisor në Traktat është thelbësor për të përgatitur terren të përshtatshëm dhe për të parandaluar rrjedhjet e emetimeve.

NERP u mundëson vendeve të përmbledhin emetimet e dioksidit sulfurik (SO₂), oksideve të azotit (NO_x) dhe pluhurit nga disa ose të gjitha termocentralet e tyre, dhe ato të harmonizohen me një kufi të përgjithshëm të emetimeve, në vend që çdo termocentral të harmonizohet me kufijtë e emetimeve të përcaktuara në anekset e Direktivës. Zhvillimi i një NERP ishte vetëm një nga opsionet për harmonizim me Direktivën; vendet vendosën vetë nëse do të zhvillonin një të tillë apo jo.¹² NERP lejon që termocentralet me djegie të brendshme të shmangin harmonizimin individual me vlerat kufitare të emetimeve (ELV) për termocentralet ekzistuese, të përcaktuara në Aneksin V, Pjesa 1 e LCPD, deri në vitin 2027. Në vend të kësaj, NERP vendos vlera kufitare periodike vjetore (2018, 2023, 2026 dhe 2027) që të gjitha emetimet e termocentraleve mbledhur së bashku nuk duhet t'i tejkalojnë, pavarësisht nga emetimet e tyre individuale.

Termocentralet me performancë më të mirë për një ndotës të caktuar mund të kompensojnë për ato me performancë më të keqe, nëse plotësohet kufiri i përgjithshëm i përcaktuar. Prandaj, NERP-ët tashmë përfaqësojnë një kompromis në krahasim me harmonizimin e plotë nga secila njësi: dështimi për t'u harmonizuar me vlerat kufitare të përcaktuara në NERP është jashtëzakonisht problematik.

Termocentralet ekzistuese me djegie të brendshme kishin gjithashtu një opsion për t'u përjashtuar nga ELV e specifikuar në LCPD ose nga përfshirja në një NERP, nëse operatori përcaktohej për një funksionim të afatizuar. Kjo mundësoi që termocentralet të funksiononin për jo më shumë se 20 000 orë, duke filluar nga 1 janari 2018 dhe duke përfunduar jo më vonë se 31 dhjetor 2023, pa pasur nevojë të harmonizojë vlerat kufitare të emetimeve. Kushti vlente për njësitë për të cilat ishte planifikuar mbyllja ose rinovimi i plotë. Për të funksionuar përtej këtyre kufijve kohorë, termocentralet duhej të jenë harmonizuar jo vetëm me vlerat kufitare të emetimeve të LCPD, por edhe me ato më të rejat dhe pak më të rrepta për termocentralet ekzistuese nga Shtojca V, Pjesa I e Direktivës së Emetimeve Industriale.

Termocentralet me qymyr të cilat janë në përputhshmëri me LCPD ende kanë implikime shëndetësore, por ato që nuk bëjnë këtë, rrisin rrezikshërinë e shëndetit dhe vdekjet e parakohshme në mënyrë të palejueshme dhe të paligjshme. Prandaj, harmonizimi me kufijtë e NERP dhe kushtet e ndalimit të funksionimit nuk janë vetëm çështje harmonizimi, por çështje jete dhe vdekjeje. Siç paraqitet në raportin tonë të vitit 2021, midis viteve 2018 dhe 2020, rreth 19 000 njerëz kanë vdekur si rezultat i ndotjes nga termocentralet e qymyrit të Ballkanit Perëndimor, nga të cilat 12 000 ishin për shkak të shkeljeve të vlerave të përcaktuara të emetimeve.¹³

Prandaj, është e domosdoshme, madje e vonuar, të ndërmerren veprime për të zvogëluar ndotjen. Ky raport i gjashtë “Përmbaju ose Mbyll” merr parasysh të dhënat zyrtare të raportuara për vitin 2023, për të parë se si ka evoluar situata që nga viti 2018. Ai ofron një pasqyrë rajonale të rezultateve, së bashku me profilet e vendeve për Bosnjë e Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë.

¹² Përveç Malit të Zi, që ka vetëm një termocentral të madh me djegie të brendshme dhe për atë arsye nuk mund të vendosë vlerë totale për më shumë termocentralet në mënyrë që ta përcaktojë kufirin kombëtar.

¹³ Rrjeti Bankwatch për EQL dhe Qendra Kërkimore për Energji dhe Ajër të Pastër (Centre for Research on Energy and Clean Air-CREA), [Comply or Close](#), CEE Bankwatch Network, shtator 2021.

Pasqyra rajonale e emetimeve të ndotësve¹⁴

Deri më 31 dhjetor 2017, që paraqet afatin e fundit për harmonizim me LCPD në vendet e Komunitetit Energjetik, operatorët e termocentraleve të qymyrit në Ballkanin Perëndimor duhet të kenë investuar në pajisjet e kontrollit të ndotjes në një shkallë të mjaftueshme, në mënyrë që të harmonizojnë vlerat kufitare të emetimeve nga Direktiva, ose të paktën për të respektuar vlerat maksimale kombëtare të përcaktuara në Planet Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve (NERP). Pas nënshkrimit të Traktatit, vendet kishin 12 vjet kohë për ta bërë këtë.

Por pavarësisht kësaj, asnjë nga vendet me termocentrale të mëdha me djegie të brendshme¹⁵ deri në fillim të 2018, madje as edhe deri edhe në fund të vitit 2023, gjashtë vjet më vonë, nuk siguroi që termocentralet e tyre me qymyr të harmonizohen me vlerat kufitare të emetimeve në nivel njësie siç parasheh Direktiva.

Nga viti 2018 deri në vitin 2022, asnjë nga katër vendet me NERP – Bosnja e Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia – nuk respektuan as vlerat për dioksidin sulfurik, për të cilat ishin zotuar në planet e tyre.

Prandaj, në mars të vitit 2021, Sekretariati i Komunitetit Energjetik hapi procese kontestimi kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë për mosrespektimin e vlerave kufitare të përcaktuara në NERP-et e tyre në vitet 2018 dhe 2019.¹⁶ Në shkurt të vitit 2022, bëri hapin e radhës duke ofruar argumente kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.¹⁷ Një opinion i argumentuar është hapi i dytë i këtij procesi, kur palës i kërkohet të korrigjojë çështjet e konstatuara të mosharmonizimit brenda një afati kohor prej dy muajsh. Varësisht nga përgjigjja e qeverisë përkatëse, Sekretariati mund t'ia paraqesë çështjen Këshillit të Ministrave për të marrë një vendim mbi harmonizimin e palës me ligjin e Komunitetit Energjetik.

Çështja kundër Serbisë mbetet e hapur, por nuk është ngritur në instancë më të lartë për shkak të paqartësive lidhur me ndikimet e investimeve aktuale në pajisjet e kontrollit të ndotjes.

Është alarmues fakti që të dhënat e përgjithshme të grumbulluara për vitin 2023, që i janë raportuar Agjencisë Evropiane të Mjedisit Jetësor¹⁸ nga Bosnja e Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, tregojnë shkelje të konsiderueshme të emetimeve për të tre ndotësit e matur – SO₂, pluhur dhe NO_x – madje edhe një rritje në emetimet e SO₂ në krahasim me vitin 2022.

Në përgjithësi, në vitin 2023 emetimet e dioksidit sulfurik ishin 5,7 herë më të larta nga vlerat e parapara në NERP e vendeve përkatëse, krahasuar me 5,6 herë më të larta në vitin 2022 dhe pesë herë më të larta se në vitin 2021.

¹⁴ Aty ku ishte e mundur, kemi përdorur statistika të emetimeve të verifikuara nga Agjencia Evropiane e Mjedisit Jetësor për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2020, që lënë përshtypjen se disa të dhëna mund të jenë deri diku të ndryshme nga ato të paraqitura në raportet e mëparshme të Përmblajit ose Mbyll.

¹⁵ Shqipëria nuk ka në funksion termocentrale të mëdha me djegie të brendshme. Termocentrali 98 MW me naftë dhe gaz në Vlorë asnjëherë nuk ka operuar me kapacitet komercial për shkak të problemeve teknike.

¹⁶ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Secretariat initiates dispute settlement procedures against four Contracting Parties in relation to NERPs](#), Energy Community, 16. mars 2021.


¹⁷ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Secretariat brings forward cases against three Contracting Parties for not reducing air pollution from thermal power plants](#), Energy Community, 23 shkurt 2022.

¹⁸ Shih [EIONET Central Data Repository](#) nën vegëzën e emrit të shtetit > Detyrimet e Bashkimit Evropian > Raportimi mbi termocentralet me djegie të brendshme.

Grafiku 1:

Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentralet me qymyr të Ballkanit Perëndimor, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018-2023

	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Emetime dioksid sulfurik	606 467	621 553	660 700	531 466	577 684	589 644
Vlera kufitare dioksid sulfurik	103 682	103 682	103 682	103 518 ¹⁹	103 518	103 518



Në vitin 2023, për herë të parë që nga skadimi i afatit LCPD, Kosova raportoi emetime më të ulëta të SO₂ se kufiri i saj i përcaktuar. Por ky indikator pozitiv humbi në peshë nga emetimet e SO₂ të Serbisë, që shënuan rritje në krahasim me vitin 2022.


Në vitin 2023 emetimet e pluhurit u ulën vetëm pak dhe ishin 1,75 herë më të larta se sa parashihej në NERP-ët e vendeve përkatëse, krahasuar me 1,8 herë në vitin 2022. Kosova, Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut përsëri tejkaluan shumë kufijtë e tyre kombëtare për emetim pluhuri.

¹⁹ Në vitin 2021 kufiri i Kosovës për SO₂ pësoi ulje të vogël.

Grafiku 2:

Emetimet e pluhurit nga termocentralet me qymyr të Ballkanit Perëndimor, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018-2023

	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Emetime pluhur	17 414	17 557	18 246	19 808	19 859	19 611
Vlera kufitare pluhur	11 200	11 200	11 200	11 180 ²⁰	11 180	11 180




Në vitin 2022, për herë të parë, emetimet totale të oksideve të azotit tejkaluan pak shumën totale të vlerave kufitare të vendeve – një shkelje e cila u rrit në gati 1,3 herë më shumë se totali i tyre në vitin 2023. Kjo ndodhi për shkak se nuk kishte investime në zvogëlimin e NO_x , niveli i kufijve vjetor për këtë ndotës nga viti në vit bëhej më strikt dhe emetimet absolute mbetën në nivele të larta. Kosova dhe Bosnja e Hercegovina ishin shkelësit kryesorë në terma relativë, megjithatë edhe Serbia gjithashtu për herë të parë tejkaloi kufirin e saj të NO_x .

²⁰ Në vitin 2021 kufiri i Kosovës për pluhurin pësoi ulje të vogël.

Grafiku 3:

Emetimet e oksideve të azotit nga termocentralet me qymyr të Ballkanit Perëndimor, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018-2023

	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Emetime oksidet e azotit	77 068	72 136	79 694	67 213	70 767	69 153
Vlera kufitare oksidet e azotit	107 353	97 226	87 100	76 768	66 641	48 344



Vitin e ardhshëm, kur do të publikohen të dhënat për vitin 2024, mund të shohim shkelje edhe më të mëdha, madje edhe nëse emetimet absolute mbeten të njëjta. Kjo për shkak se vlerat e përcaktuara të dioksidit sulfurik dhe pluhurit në NERP nuk ndryshuan në shumicën e rasteve mes viteve 2018 dhe 2023,²¹ por janë më të ulëta në vitin 2024.

Nga kjo më lartë supozohet se të dhënat e emetimeve janë të sakta. Megjithatë, shumë nga të dhënat e ofruara nga operatorët e termocentralit janë më shumë vlerësime sesa rezultat i monitorimit të vazhdueshëm. Direktiva për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme²² i detyron vendet të instalojnë dhe operojnë pajisje të vazhdueshme për monitorim të emetimeve, por deri më sot pothuajse gjysma e termocentraleve me qymyr në Ballkanin Perëndimor ose nuk kanë pajisje të tilla të instaluara, ose pajisjet ekzistuese nuk funksionojnë. Prandaj, të dhënat e emetimeve për të gjitha vendet bazohen të paktën pjesërisht në vlerësimet e nxjerra nga matjet një herë në muaj dhe ndonjëherë edhe matjet e kryera një herë në tre muaj.

²¹ Në vitin 2021 kufiri i Kosovës për pluhur dhe SO₂ pësoi ulje të vogël.

²² Neni 12 i [Direktivës për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme](#).

Posaçërisht të dyshimta ishin matjet në Maqedoninë e Veriut gjatë vitit 2023. Asnjë nga termocentralet me qymyr nuk ka monitorim të vazhdueshëm dhe më parë raportonin vetëm në bazë të llogaritjeve të bëra nga matjet e kryera një herë në muaj. Por në vitin 2023 monitorimi mujor tregoi variacione të mëdha në matje dhe dukej jo i besueshëm. Pra, kur raportuan të dhënat e tyre në Agjencinë Evropiane të Mjedisit Jetësor, autoritetet përdorën faktorët e emetimeve nga vitet 2020, 2021 dhe 2022, në kombinim me inputin e energjisë termike për të gjeneruar një vlerësim të emetimeve nga djegia e qymyrit. Megjithatë, rreth një e treta e gjashtë milionë tonëve linjit të nevojshëm për funksionimin e termocentralit të Manastirit është importuar në vitin 2023 nga miniera të ndryshme të qymyrit në rajon.²³ Përdorimi i faktorëve të nënkuptuar të emetimeve nga vitet e mëparshme është i dobishëm vetëm nëse karakteristikat e karburantit dhe efikasiteti i zvogëlimit janë shumë të qëndrueshme, kështu që prodhimi i energjisë dhe emetimet e lidhura me to nuk mund të llogariten thjesht pa marrë në konsideratë, në mënyrë proporcionale, ndryshimet në karakteristikat e karburantit të qymyrit të importuar, duke përfshirë p.sh. përmbajtjen e squfurit, lagështinë etj.

Në vitin 2023, termocentralet me qymyr të Serbisë, të përfshira në NERP e saj, ishin emetuesit më të lartë të SO₂, me 296 011 tonë, pasuar nga ato të Bosnjë e Hercegovinës me 181 807 tonë. Emetimet e SO₂ në termocentralet e Serbisë u rritën ndjeshëm në krahasim me vitin 2022, kur ato emetuan 261 217 tonë SO₂, ndërsa ato të Bosnjë e Hercegovinës qëndruan pothuajse të njëjta (182 667 tonë në vitin 2022).

Në terma absolutë, në vitin 2023 shkelësi i vjetër Ugljevik në Bosnjë e Hercegovinë ishte njësia me emetimin më të lartë të SO₂ në rajon, me 97 189 tonë.

Pavarësisht instalimit të një njësie desulfurizimi, SO₂ e saj u rrit në krahasim me vitin 2022, kur termocentrali emetoi 85 526 tonë. Gjatë vitit 2023 pajisja e desulfurizimit nuk ka funksionuar rregullisht, pavarësisht se testimi thuhet se ka përfunduar me sukses në gusht të vitit 2020²⁴ dhe është marrë një leje operimi për de-SO_x në nëntor të vitit 2021.²⁵ Duket gjithnjë e më e dyshimtë që ky projekt 85 milionë eurosh ndonjëherë do të përdoret siç duhet për të sjellë termocentralin e Ugljevikut në përputhshmëri me vlerat kufitare të saj për SO₂ dhe me vlerat kufitare të Direktivës së Emetimeve Industriale që duhet t'i arrijë deri në vitin 2027.

Në vitin 2023 Nikola Tesla B në Serbi gjithashtu kishte emetime jashtëzakonisht të larta absolute të SO₂ – 92 260 tonë. Aktualisht është duke u instaluar një njësi desulfurizimi (shih pjesën e raportit për Serbinë), por përvoja me Ugljevik dhe Kostolac B (shih më poshtë) tregon se nuk ka asnjë garanci që do të ketë harmonizim.

Megjithëse vlerat kufitare individuale të njësive nuk janë të detyrueshme – të tilla janë vetëm ato në nivel vendi – duke parë shkeljet e këtyre vlerave në nivel njësie, në sipërfaqe dalin tregues të mirë se ku nevojiten intervenime të veçanta. **Në vitin 2023 së paku katër termocentralet tejkaluan vlerat kufitare të tyre për emetimet e dioksidit sulfurik me më shumë se dhjetë herë:**

- Ugljevik, Bosnjë e Hercegovinë: 10,7 herë
- Kakanj 7, Bosnjë and Hercegovinë: 10,7 herë
- Bitola 1 & 2, Maqedoni e Veriut: 10,6 herë
- Kostolac A2, Serbi: 10,5 herë

Sado të tmerrshme, këto të dhëna paraqesin një rënie në krahasim me vitin 2022 për Bitola 1 & 2 dhe Kakanj 7. Por ato tregojnë një rritje për Ugljevik dhe Kostolac A2.

Kostolac B, një nga emetuesit më të lartë absolut dhe relativ të dioksidit sulfurik nga viti 2018 deri në vitin 2020, më në fund filloi të ulë emetimet e tij në vitin 2021. Megjithatë, që atëherë emetimet e tij të SO₂ janë rritur, pavarësisht se është instaluar një njësi desulfurizimi. Në vitin 2023, emetimet e tij të SO₂ arritën në 45 803 tonë, krahasuar me 36 560 tonë në vitin 2022 dhe 26 015 tonë në vitin 2021.

Njësia e saj e desulfurizimit, e instaluar nga Korporata e Inxhinierisë Maqinerike të Kinës (CMEC), u inaugurua zyrtarisht në vitin 2017, por mori një leje operimi vetëm në janar të vitit 2023.²⁶ Emetimet nga 2021 në vitin 2023, megjithëse në rritje, janë më të ulëta se ato për periudhën 2018-2020 dhe tregojnë se objekti duhet të ketë qenë pjesërisht në përdorim. Por në vitin 2023, ai ende emetonte gati 5,8 herë më shumë SO₂ sesa lejohej sipas NERP.

²³ Sërgjan Stojančov, 'Промена на планот на ЕСМ – помалку ископ, повеќе увоз на јаглен', TV Telma, 25 shkurt 2024.

²⁴ RiTE Ugljevik, 'Izuzetni rezultati u zaštiti životne sredine', RiTE Ugljevik, 27 gusht 2020.

²⁵ Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Mjedisit Jetësor e Republika Sërpëskë, 'Vendimi nr. 15.03-360-164/21', 11 nëntor 2021.

²⁶ Instituti Rregullator për Mjedis Jetësor dhe Energji të Rinovueshme, 'Desulphurisation in the Western Balkans, Renewables and Environmental Regulatory Institute (RERI)', mars 2023.

Emetues më i lartë absolut i pluhurit në rajon ishte Kosova B2 në Kosovë. Ajo emetoi 3 798 tonë – një rritje e madhe nga 2 517 tonë në vitin 2022, dhe 9,2 herë më shumë se sa lejohet sipas NERP të Kosovës.

Në terma relativë, termocentrali Gacko në Bosnjë e Hercegovinë kishte tejkalimin më të lartë të pluhurit, pasi emetonte pothuajse 10,7 herë më shumë nga vlera maksimale e lejuar në NERP. Me 3 241 tonë, kjo përfaqësonte një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2022, kur emetoi 12 herë më shumë nga vlera e lejuar, pra 3 649 tonë.

Emetues tjerë shumë të lartë të pluhurit në rajon janë Kosova B njësisia 1, e cila ka emetuar 2 136 tonë në vitin 2023, ose 5,2 herë më shumë nga vlera e lejuar, dhe Bitola 1 & 2 që kanë emetuar 2 582 tonë, ose 3,1 herë më shumë nga vlera kufitare.

Në vitin 2023 Nikola Tesla B në Serbi kishte emetimet më të larta absolute të oksideve të azotit, me 11 633 tonë – një rritje e konsiderueshme nga 8 500 tonë në vitin 2022.

Në terma relativë, në vitin 2023 Kosova A4 ishte shkelësi më i keq sa i përket emetimeve të oksideve të azotit, duke emetuar 4,2 herë më shumë nga vlera maksimale e lejuar, ose 2 761 tonë.

Të tre vendet me termocentrale që hynë në regjimin e afatizuar për ndalim funksionimi, tani janë gjithashtu duke shkelur LCPD.

Në vitin 2018 tetë njësi në Bosnjë e Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi hynë në të ashtuquajturin regjim 'opt-out': Tuzla 3 dhe 4, Kakanj 5, Pljevlja, Morava, Kolubara A3 (Ngrohtorja 1), Kolubara A3 (Ngrohtorja 3, 4, 5) dhe Kolubara A5.²⁷ Por asnjëri prej tyre nuk ka respektuar ELV-të përkatëse, pavarësisht se afati i 31 dhjetorit 2023 ka kaluar shumë kohë më parë dhe shumica ose të gjitha kanë tejkaluar kufijtë e tyre prej 20 000 orësh pune. Gjithashtu, deri në fillim të gushtit 2024, asnjë prej tyre nuk është mbyllur ende.

Termocentrali Pljevlja në Mal të Zi iu nënshtrua një intervenimi, ndërsa me një vendim të Parlamentit të Federatës së BeH në mars të vitit 2022 Tuzla 4 dhe Kakanj 5 iu zgjat afati i funksionimit.²⁸ Në fillim të vitit 2023 Elektroprivreda Srbije (EPS) njoftoi se do të mbyllte termocentralet Kolubara dhe Morava vetëm në fund të vitit 2024,²⁹ por afati tashmë duket se ka ndryshuar për vitin 2026.³⁰ Fati i Tuzla 3 nuk është plotësisht i qartë, pasi nuk është marrë asnjë vendim për zgjatjen e afatit të saj të funksionimit, por nuk ka as njoftime për mbyllje (shih pjesën e raportit për Bosnjën e Hercegovinën).³¹

Për shkak të shkeljeve të dispozitave për ndalim funksionimi, në prill të vitit 2021 Sekretariati i Komunitetit Energjetik hapi konteste kundër Malit të Zi,³² në tetor të vitit 2022 kundër Bosnjës e Hercegovinës³³ dhe në tetor të vitit 2023 kundër Serbisë.³⁴

Në përgjithësi, gjashtë vjet pas kalimit të afatit të harmonizimit me LCPD në Komunitetin Energjetik, situata mbetet brengosëse. Që nga viti 2018, emetimet e dioksidit sulfurik dhe oksidet e azotit të parapara në NERP mezi janë ulur, madje emetimet e pluhurit kanë shënuar rritje. Asnjë nga termocentralet e planifikuara nuk është mbyllur.

Shkelje edhe më të mëdha mund të ndodhin këtë vit për shkak të uljes së vlerave maksimale të përcaktuara në NERP për tre ndotësit e matur. I vetmi faktor i mundshëm lehtësues është njësisia e desulfurizimit, e cila u hap në termocentralin Nikola Tesla A në Serbi këtë prill.³⁵ Por si gjithmonë, suksesi i saj varet nëse me të vërtetë përdoret.

²⁷ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Energy Community Secretariat's Summary Report on the final list of opted-out plants](#), prill 2018.

²⁸ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, ["Environmental concerns increase with decision on lifetime extension of Tuzla 4 and Kakanj 5"](#), Energy Community, 25 mars 2022.

²⁹ Vladimir Spasiq, ["EPS sets out plan for shutting down coal power plants"](#), Balkan Green Energy News, 16 shkurt 2023.

³⁰ Elektroprivreda Srbije, [Трогодишњи план пословања Акционарског друштва „Електропривреда Србије“](#), Београд за период 2024-2026.г.- ИЗВОД, Elektroprivreda Srbije, janar 2024.

³¹ Biznis Plani 2024-2026 i Elektroprivreda BiH përmend mbylljen e njësisë në vijë me LCPD, por parasheh më shumë, e jo më pak, prodhim energjie në termocentralet e saj për vitet 2024 dhe 2025, në krahasim me vitin 2023, edhe pse nuk janë zgjeruar me kapacitete të reja prodhuese. Shih Elektroprivreda BiH, [Plan poslovanja za period 2024.- 2026. godina](#), Elektroprivreda BiH, mars 2024.

³² Sekretariati i Komunitetit Energjetik, ["Secretariat launches dispute settlement procedure against Montenegro for breaching Large Combustion Plants Directive as TPP Pljevlja exhausts 'opt-out'"](#).

³³ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, ["Secretariat launches dispute settlement procedure against Bosnia and Herzegovina for breaching Large Combustion Plants Directive in the case of Tuzla 4 and Kakanj 5"](#).

³⁴ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, ["Secretariat launches dispute settlement procedure against Serbia for breaching the Large Combustion Plants Directive in the case of TPP Morava"](#).

³⁵ Igor Todorović, ["Mitsubishi Power commissions desulfurization system in Serbia's TENT A coal plant"](#).

Paqartësitë e NECP për ndalimin e qymyrit

Qeveritë dhe ndërmarrjet komunale në Ballkanin Perëndimor për vite me radhë e kanë paraqitur qymyrin si një burim të besueshëm energjetik të brendshëm, por që nga viti 2024 mosha mesatare e njësive energjetike të qymyrit në rajon është 47 vjet. Dhe viteve të fundit furnizimi me qymyr ka qenë një problem i madh për Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë.

Kombinuar me faktorë të tjerë si mbështetja e tepërt në hidrocentralet që cenohen nga ndryshimet klimatike dhe çmimet e larta të gazit që përkthehen në çmime të larta të importit të energjisë, gjatë stinës së dimrit viteve 2021-2022 dhe 2022-2023 disa vende vuajtën nga ndërprerjet në termocentralet me qymyr dhe krizat e energjisë elektrike – kryesisht Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Shqipëria, siç përshkruhet më hollësisht në raportin tonë Përmbajë ose Mbyll 2023.

Këto zhvillime nënvizuan rëndësinë e investimit në kapacitetet e reja për energji solare dhe të erës, por kompanitë i përdorën gjithashtu si një justifikim për të zgjidhur afatin e funksionimit të njësive Tuzla 4 dhe Kakanj 5 në Bosnjë e Hercegovinë dhe për të rikthyer në përdorim pas 12 vitesh termocentralin me naftë industriale të Negotinës në Maqedoninë e Veriut.³⁶ Krizat akute janë zbutur tani për tani, por mbetet e paqartë për sa kohë.

Nga njëra anë, ka pasur disa lëvizje premtuese për investime në instalime me erë dhe solare, dhe në vitin 2023 në Maqedoninë e Veriut u shënuar një avancim në energjinë diellore me zgjerimin e kapaciteteve për 362 MW, duke rritur totalin në 506 MW.³⁷ Kjo, së bashku me një ulje të lehtë të kërkesës, në vitin 2023 i mundësoi vendit të ulë neto-importet vjetore të energjisë nga një mesatare prej 20 deri në 30 përqind të konsumit në vetëm 2,75 përqind.³⁸ Madje edhe në Bosnjë e Hercegovinë dhe Mal të Zi, të cilat janë neto eksportues energjie elektrike, kohët e fundit nuk ka pasur ndonjë përparim në mbylljen e termocentraleve të qymyrit apo së paku në përcaktimin e afateve për mbyllje.

Deri në fund të qershorit të vitit 2023 të gjitha qeveritë e Ballkanit Perëndimor duhej të dorëzonin draft-Planet e tyre Kombëtare Energjetike dhe Klimatike (NECP) në Sekretariatit e Komunitetit Energjetik dhe planet e tyre përfundimtare deri në fund të qershorit 2024. Me NECP vendet përkatëse duhej përfundimisht të kenë qartësuar planet që termocentralet e tyre të qymyrit të ishin të harmonizuara ose të mbylleshin, por deri në mes të korrikut 2024 kjo nuk ndodhi, kur ky raport akoma përgatitej.

Serbia, Bosnja e Hercegovina dhe Kosova dorëzuan draft NECP në qershor dhe korrik 2023, por deri në fund të korrikut 2024, dy të fundit nuk kishin miratuar versionet përfundimtare. Serbia miratoi NECP e saj përfundimtar në fund të korrikut. Draftet e Bosnjë e Hercegovinës dhe Kosovës parashohin disa hapa në lidhje me termocentralet e qymyrit që do të ndërmerren para vitit 2030, mirëpo disa detaje kanë mbetur të paqarta. Drafti i Serbisë ishte edhe më pak i qartë se çfarë do të ndodhte me secilin termocentral dhe kur do të ndodhte kjo.³⁹ Asnjë nga draftet nuk përmendi datat e ndalimit të përdorimit të qymyrit më herët se afati i përgjithshëm i BE për neutralitet karboni në vitin 2050.

Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut miratuan NECP e tyre në vitin 2021, gjegjësisht në vitin 2022. Drafti i NECP i Maqedonisë së Veriut⁴⁰ vendos heqjen e qymyrit nga përdorimi në vitin 2027, por versioni përfundimtar përmban një paragraf shtesë me një opsion për ta zgjidhur këtë deri në vitin 2029,⁴¹ dhe që atëherë dokumentet e qeverisë e kanë cituar si afat vitin 2030. Si Shqipëria, ashtu edhe Maqedonia e Veriut, duhet të përditësojnë NECP-të e tyre, pasi ato nuk përfshinin objektivat e Komunitetit Energjetik 2030.⁴² Qeveria e re e Maqedonisë së Veriut, e formuar në qershor 2024, gjithashtu mund të sjellë ndryshime në politikën e saj energjetike.

Deri në fund të korrikut 2024, Mali i Zi nuk ka publikuar fare draft NECP për konsultim publik. Ajo ishte zotuar më parë për një datë të heqjes së qymyrit nga përdorimi në vitin 2035,⁴³ por realiteti ekonomik mund t'i detyrojë për një mbyllje më të hershme të termocentralit Pljevlja.

³⁶ Dragana Petrushevska, 'N. Macedonia starts up TEC Negotino power plant - report', *SEENews*, 16 dhjetor 2021.

³⁷ Komisioni Rregullator i Energjetikës, Shërbimeve të Ujit dhe Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturinat Komunale i Republikës së Maqedonisë së Veriut (ERC), *Annual Report 2023*, ERC, prill 2024.

³⁸ Ibid.

³⁹ Deri më 29 korrik, versioni përfundimtar nuk ishte i disponueshëm për publikun, kështu që nuk mund të analizohej në kohë për këtë botim.

⁴⁰ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *National Energy and Climate Plan of the Republic of North Macedonia*, Draft, Government of the Republic of North Macedonia, korrik 2020.

⁴¹ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *National Energy and Climate Plan of the Republic of North Macedonia*, Government of the Republic of North Macedonia, 31 maj 2022.

⁴² Shih p.sh.: Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Accelerating Coal Transition Investment Plan for the Republic of North Macedonia – Pelagonia and Southwest regions*, Climate Investment Funds, janar 2024.

⁴³ Përtej lëndëve djegëse fosile, *Europe's coal exit - Overview of national coal phase out commitments*, Beyond Fossil Fuels, përditësimi i fundit 10 qershor 2024.

Profilet e shteteve

Bosnja e Hercegovina (BeH)

Harmonizimi me vlerat kufitare të NERP në vitin 2023

NERP i Bosnjë-Hercegovinës⁴⁴ mbulon shtatë njësi që operojnë me qymyr⁴⁵ dhe një termocentral më të vogël industrial që përdor naftë industriale. Nga këto, dy njësi, Gacko dhe Ugljevik, gjenden në Republika Sërpse, ndërsa termocentralet Tuzla dhe Kakanj – secila me nga dy njësi të përfshira në NERP, gjenden në Federatën e Bosnjë e Hercegovinës (FBH).

Tre njësi tjera – Tuzla 3, Tuzla 4 dhe Kakanj⁵⁴⁶ – iu nënshtruan afatizimeve për funksionim ("regjimi opt-out") (shih pjesën më poshtë).

BeH ka gjithashtu një termocentral më të ri, i cila nuk kualifikohet për t'u përfshirë në NERP – Stanari, në Republika Sërpse, që zyrtarisht u vu në funksion në shtator të vitit 2016 dhe ishte i detyruar të respektojte vlerat kufitare të LCPD për termocentralet e reja sapo të fillonte të operojë.

Edhe një herë në vitin 2023, termocentralet e Bosnjës e Hercegovinës me qymyr, të përfshira në NERP, nuk respekton vlerat kufitare të ndotjes për asnjë nga ndotësit e kërkuar: dioksid sulfurik, pluhur ose oksidet e azotit.

Ashtu si në shumicën e vendeve, dioksidi sulfurik është problemi më i rëndë. **Në vitin 2023, ashtu si në vitin 2022, emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentralet e BeH të përfshira në NERP, arritën të emetojnë tetë herë më shumë nga ajo që lejohej** – 181 807 tonë, krahasuar me vlerat e lejuara prej 22 195 tonësh. Kjo mezi që përfaqësonte ndonjë rënie në krahasim me vitin 2022, kur njësitë e përfshira në NERP emetuan 182 667 tonë SO₂.


⁴⁴ USAID, [National Emission Reduction Plan for Bosnia and Herzegovina](#), Komuniteti Energjetik, nëntor 2015.

⁴⁵ Teksti i NERP poashtu përfshin Kakanj 5 dhe Tuzla 4, por këto termocentrale më vonë u kualifikuan për funksionim të afatizuar, kështu që vlerat aktuale për BeH nuk përfshijnë emetimet e këtyre termocentraleve.

⁴⁶ Sekretariati i Komunitetit Energjetik [Report on the final list of opted-out plants](#), Komuniteti Energjetik, prill 2018.

Grafiku 4:

Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentralet e qymyrit të Bosnjës e Hercegovinës, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018-2023




Në vitin 2023 shkelësi më i keq në BeH dhe në rajon për sa i përket emetimeve absolute ishte Ugljevik, ku ishte shumë e qartë që pajisja e desulfurizimit nuk funksiononte, pavarësisht se kishte marrë leje operimi në nëntor të vitit 2021.⁴⁷ Emetimet e tij në vitin 2023 prej 97 189 tonë ishin më të larta se ato në vitet 2022 (85 526 tonë) dhe 2021 (86 774 tonë). Në përgjithësi, që nga viti 2018, emetimet e dioksidit sulfurik të këtij termocentrali janë rritur.

⁴⁷ Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Mjedisit Jetësor e Republika Sërpse, [Decision no. 15.03-360-164/21](#), 11 nëntor 2021.

Grafiku 5:

Emetimet e dioksidit sulfurik nga Ugljevik, krahasuar me vlerën kufitare individuale të emetimeve, 2018-2023




Në vitin 2023, Kakanj 7 dhe Ugljevik kishin tejkalimet më të larta të dioksidit sulfurik në Bosnjë e Hercegovinë. Të dy emetuan 10,7 herë më shumë nga vlerat e përcaktuara në NERP.

Në vitin 2023, emetimet e pluhurit nga termocentralet e Bosnjë e Hercegovinës të pëfshira në NERP, arritën në 4 647 tonë – 2,7 herë më shumë se kufiri i lejuar. Kjo ishte pak më pak se vlerat e vitit 2022 (4 892 tonë) dhe përfaqësonte një rënie nga kulminacioni i vlerave të vitit 2021 prej 6 040 tonësh, por ishte ende dukshëm më shumë se 2 686 tonë të emetuar në vitin 2020.

Grafiku 6:

Emetimet e pluhurit nga termocentralet me qymyr të Bosnjës e Hercegovinës, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018-2023



Ky nivel shumë i lartë ishte kryesisht për shkak të emetimeve masive të pluhurit nga termocentrali Gacko, të cilat ishin 10,7 herë më të larta se vlera kufitare individuale e termocentralit në vitin 2023.

Në maj të vitit 2023, banorët e zonës së Nadiniqit mbajtën një protestë për shkak të ndotjes,⁴⁸ dhe rrjedhimisht u bënë përpjekje për të zgjidhur problemin. Në gusht të vitit 2023 u raportua se intervenimet në elektrofiltrin përkatës nuk kishin sjellë përmirësime të dukshme,⁴⁹ por deri në tetor mund të priteshin ndryshime të vogla pozitive. Megjithatë, gjithashtu u paralajmërua se kjo ishte një zgjidhje e përkohshme dhe do të nevojiteshin investime të mëtejshme.⁵⁰ Në bazë të të dhënave të emetimeve, të cilat raportohen vetëm si një shifër e përmblendhur vjetore, përmirësimet e raportuara nuk japin rezultat.

⁴⁸ Nëpër Hercegovinën e Vjetër, 'RiTE Gacko: Saopštenje za javnost', Kroz Staru Hercegovinu, 16 maj 2023.

⁴⁹ Radio Televizioni i Republika Sërpskës, 'Ремонт термоелектране Гацко завршен - проблем загађења остао: У плану набавка пречистача угља (ВИДЕО)', RTRS, 26 gusht 2023.


⁵⁰ Radio Televizioni i Republika Sërpskës, 'Gacko: Privremeno riješen problem zagađenja zraka', RTRS Vijesti, 8 tetor 2023.

Termocentralet Gacko, Bosnja e Hercegovina

Foto: Andrey Ralev

Grafiku 7:

Emetimet e pluhurit nga termocentrali Gacko, krahasuar me vlerën kufitare individuale të emetimeve, 2018-2023



Emetimet e pluhurit nga termocentrali Ugljevik u rritën edhe në vitin 2023, duke arritur në 3,2 herë më shumë se vlera kufitare e termocentralit.

Në vitin 2023 emetimet e oksideve të azotit nga njësitë e qymyrit të BeH, të përfshira në NERP, arritën në 11 752 tonë, krahasuar me kufirin e lejuar prej 7 371 tonëve. Kjo përfaqësonte një rënie të lehtë, krahasuar me 11 944 tonë në vitin 2022.

Sidoqoftë, emetimet e NO_x në vitin 2023 ishin 1,6 herë më të larta se vlera maksimale – më shumë se në vitin 2022 kur ishin 1,3 herë më të larta, sepse kufiri i NERP për NO_x çdo vit zvogëlohet në mënyrë lineare.

Në vitin 2023, Gacko dhe Kakanj 7 kishin tejkalimin më të lartë të NO_x , me 2,4 herë më shumë nga vlera e lejuar. Pastaj radhitej Ugljevik, me 2,3 herë më shumë NO_x nga vlera e lejuar.


Termocentralet Kakanj, Bosnja e Hercegovina

Foto: CZZS



Grafiku 8:

Emetimet e oksidit të azotit nga termocentralet me qymyr të Bosnjës e Hercegovinës, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018-2023



Bosnja e Hercegovina (2023)

Vlera kufitare e SO ₂ ⁵¹	Emetimet e SO ₂	Vlera kufitare e pluhurit	Emetimet e pluhurit	Vlera kufitare e NO _x	Emetimet e NO _x
22 195	181 807	1 690	4 647	7 371	11 752

Në mars të vitit 2021, për shkak të shkeljeve të vlerave kufitare të përcaktuara në NERP, Sekretariati i Komunitetit Energjetik hapi një kontest kundër Bosnjës e Hercegovinës, së bashku me rastet kundër vendeve të tjera. Më 13 korrik 2023, Sekretariati i paraqiti Këshillit të Ministrave një kërkesë me sqarime për të marrë një vendim që konfirmonte mosharmonizimin e kryer, gjë që Këshilli e bëri në dhjetor të vitit 2023.⁵² Meqenëse shkeljet nuk janë korrigjuar, në fund të korrikut 2024 çështja akoma mbetet hapur.⁵³

Në përgjithësi në Bosnjë dhe Hercegovinë, që nga viti 2018 emetimet e dioksidit sulfurik dhe pluhurit nga termocentralet e përfshira në NERP janë rritur, ndërsa vetëm emetimet e oksidit të azotit shënojnë ulje, pavarësisht mungesës së investimeve në pajisjet e denitrifikimit.

'Përrjashtim' nga harmonizimi

Siç u përmend më lart, Tuzla 3, Tuzla 4 dhe Kakanj ⁵⁴ iu nënshtruan të ashtuquajturit regjim 'opt-out', i cili u mundësoi tre termocentraleve të funksionojnë për një total prej 20 000 orësh ndërmjet 1 janarit 2018 dhe 31 dhjetorit 2023. Pas kësaj, ata ose duhej të mbyllen ose të harmonizohen me vlerat kufitare të emetimeve për termocentralet e reja, sipas Direktivës së Emetimeve Industriale.

⁵¹ Vlerat kufitare bazë të BeH në NERP përfshinin Kakanj 5 dhe Tuzla 4, që më vonë u përfshinë në regjimin 'opt-out', kështu që kalkulimet për vlerat kufitare u bazuan në shumën e vlerave kufitare të termocentraleve tjera.

⁵² Këshilli i Ministrave i Komunitetit Energjetik, [Decision 2023/06/MC-EnC on the failure by Bosnia and Herzegovina to comply with the Energy Community Treaty in Case ECS-9/21](#), Energy Community, 14 dhjetor 2023.

⁵³ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Case ECS 09/21, Bosnia and Herzegovina/Environment, Energy Community](#), së fundmi lexuar më 26 korrik 2024.

⁵⁴ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Report on the final list of opted-out plants](#).

Që nga 1 janari 2018 deri në fund të vitit 2023, Tuzla 3 kishte harxhuar 19 476 orë, por për shkak të skadimit të afatit, edhe ashtu duhej të mbyllej. Nuk është e qartë nëse kjo ka ndodhur, pasi nuk është marrë asnjë vendim që të vazhdojë me punë, por nuk ka as njoftime për mbyllje.⁵⁵ Ekzistojnë plane të diskutueshme për zëvendësimin e tij me një termocentral që operon me biomasa, por ende nuk është e qartë nëse dhe kur do të fillojë.⁵⁶

Siç është paraqitur në raportet e mëparshme Përmbaju ose Mbyll,⁵⁷ Tuzla 4 dhe Kakanj 5 kanë vazhduar të punojnë pas datës së tyre ligjore të skadencës. Pasi të kenë shfrytëzuar 20 000 orët e tyre, ato mund të operojnë vetëm nëse plotësojnë vlerat kufitare të emetimeve, të përcaktuara në Pjesën 2 të Aneksit V të Direktivës 2010/75/BE.⁵⁸ Askund në dokumentacionin e ofruar nga operatori i termocentralit, Elektroprivreda Bosne i Hercegovine (EPBiH), dërguar qeverisë apo në dokumentacionin e ofruar nga qeveria parlamentit të FBiH, nuk sugjerohet se janë planifikuar investime që do ta mundësonin një harmonizim të tillë.

Në tetor të vitit 2022, Sekretariati i Komunitetit Energjetik ngriti një rast të dytë kundër Bosnjës e Hercegovinës për mospërputhje me Direktivën për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme.⁵⁹

Investimet aktuale për kontrollin e ndotjes

Në vitin 2023, sërish nuk kishte investime domethënëse për të ulur ndotjen nga qymyri, megjithëse u ndërmorën hapa të përkohshëm për të zbutur ndotjen ekstreme me pluhur nga Gacko.

Bosnja e Hercegovina deri më tani nuk ka dalë me një plan të qartë për të hequr gradualisht qymyrin. Parashikimet zyrtare⁶⁰ që disa nga termocentralet e përfshira në NERP do të funksionojnë edhe pas vitit 2030 nuk janë reale. Edhe duke llogaritur termocentralin më të ri Stanari, i cili u hap në vitin 2016, termocentralet e qymyrit në BeH janë mesatarisht 44 vjeç. Termocentralet e NERP kanë një mesatare pak më të ulët prej 42 vitesh, por vetëm Ugljevik ka pajisje desulfurizimi, madje edhe ajo nuk funksionon. Pra, është e vështirë të imagjinohet se instalimi i de-SO_x në termocentralet e mbetura ka arsyeshmëri ekonomike, por vazhdimi me nivelet aktuale të ndotjes është jashtëzakonisht i dëmshëm për shëndetin e njeriut, e poashtu edhe i paligjshëm.

Për sa i përket Ugljevik, siç u përmend më lart dhe u diskutua më në detaje në botimet e mëparshme të Përmbaju ose Mbyll, termocentrali mori një leje operimi për njësinë de-SO_x në nëntor të vitit 2021.⁶¹ Megjithatë, kjo nuk ka rezultuar me ulje të emetimeve.

Fillimisht ishte e paqartë pse de-SO_x në Ugljevik nuk funksionoi, por në një përgjigje të prillit 2023 drejtuar Qendrës për Mjedis Jetësor, operatori i termocentralit RiTE Ugljevik deklaroi se nuk funksionon vazhdimisht sepse paraqet një 'barrë ekonomike'.⁶² Kur punon, de-SO_x i nevojiten 11 MWh energji elektrike dhe 600 tonë në ditë gur gëlqeror. Së bashku me kostot e magazinimit ose asgjësimit të gipsit që rezultojnë nga procesi, operatori i termocentralit ka rreth 20 000 euro shpenzime në ditë.⁶³

Lidhur me ndotjen e madhe me pluhur që shkakton termocentrali Gacko, siç u përmend më lart, në tetor të vitit 2023 u raportua se problemi ishte zbutur, por se do të nevojiteshin investime të mëtejshme për të siguruar përmirësime permanente, duke përfshirë një njësi për "pastrimin" e qymyrit.⁶⁴ Rënia e cilësisë së qymyrit është gjithashtu një problem në rritje. Një tërmet në vitin 2022 groposi një pjesë të minierës nën ujë, me gjithë pajisjet;⁶⁵ flitet se ende ekziston linjit me cilësi më të mirë në minierat e përmytura të termocentralit, por gjendet më thellë dhe deri te ai arrihet më vështirë.⁶⁶

Në maj të vitit 2023, u thirr një konsultim publik mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor për planet që në termocentralin Gacko të fillohet me djegien e të ashtuquajturit karburant me origjinë nga mbeturina të ndryshme (RDF) (d.m.th. mbeturinat komunale që mund ose nuk mund të jenë përpunuar deri në një farë mase).⁶⁷ Në çdo rast ky do të ishte një propozim shumë problematik, por mungesa e kontrollit të ndotjes nga termocentrali e bën veçanërisht të vështirë për t'u kuptuar. Fatmirësisht, në gusht të vitit 2023, pas rezistencës së konsiderueshme nga banorët dhe punëtorët vendas, drejtori i termocentralit deklaroi se përdorimi i karburantit RDF për momentin nuk është prioritet për këtë termocentral.⁶⁸

⁵⁵ Biznis Plani 2024-2026 i Elektroprivreda BiH përmend mbylljen e njësisë në vijë me LCPD, por parasheh më shumë, por jo më pak prodhim energjie elektrike në termocentralet e saj me qymyr për vitet 2024 dhe 2025, krahasuar me vitin 2023, edhe pse nuk është zgjeruar me kapacitete të reja. Shih Elektroprivreda BiH, [Plan poslovanja za period 2024. - 2026. godina](#).

⁵⁶ Klix.ba, 'Šta bi značilo prelazak Bloka 3 Termoelektrane Tuzla na biomasu i kada bi se to moglo desiti', Klix, 21 janar 2024.

⁵⁷ Rrjeti Bankwatch për EQL, [Comply or Close](#), CEE Bankwatch Network, qershor 2022.

⁵⁸ Këshilli i Ministrave i Komunitetit Energjetik, [D/2015/07/MC-EnC: On amending Decision D/2013/05/MC-EnC of 24 October 2013 on the implementation of Directive 2001/80/EC of the European Parliament and of the Council on the limitation of emissions of certain pollutants into the air from large combustion plants and on amending Annex II of the Energy Community Treaty](#), Energy Community, 16 tetor 2015.

⁵⁹ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, 'Secretariat launches dispute settlement procedure against Bosnia and Herzegovina for breaching Large Combustion Plants Directive in the case of Tuzla 4 and Kakanj 5'.

⁶⁰ P.sh. prej Ministrisë së Tregëtisë dhe Marrëdhënieve Ekonomike me Jashtë e Bosnjës e Hercegovinës, [Framework Energy Strategy of Bosnia and Herzegovina until 2035](#), Ministry of Foreign Trade and Economic Relations of Bosnia and Herzegovina, 69, së fundmi lexuar më 2 korrik 2021.

⁶¹ Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Mjedisit Jetësor e Republika Sërpskës, [Decision no. 15.03-360-164/21](#), 11 nëntor 2021.

⁶² RiTE Ugljevik, Letra nr: 14047/23, 18 prill 2023.

⁶³ Ibid.

⁶⁴ Radio Televizioni i Republika Sërpskës, 'Gacko: Privremeno riješen problem zagađenja vazduha'.

⁶⁵ Radio Televizioni i Republika Sërpskës, 'Može li kvalitet uglja dovesti u pitanje rad TE Gacko?', RTRS Vijesti, 23 shkurt 2024.

⁶⁶ Ibid.

⁶⁷ Dejan Tovilović, 'TE Gacko će spaljivati evropsko smeće?', Capital, 12 maj 2023.

⁶⁸ Milanka Kovačević, 'Skoko – RDF gorivo za menadžment RiTE Gacko: više nije tema, ERS – razmatramo ideje i načine korišćenja RDF goriva', Direkt, 25 gusht 2023.



Pavarësisht se nuk është në gjendje të kontrollojë ndotjen nga planet ekzistuese të Ugljevik dhe Gacko, Republika Serpska vazhdon të japë leje për termocentrale të reja me qymyr në të njëjtat lokacione. Termocentrali Ugljevik III i Comsar Energy ka marrë vazhdimisht miratime për vlerësimet mbi ndikimin në mjedis dhe leje ekologjike, pavarësisht shkeljeve të dukshme ligjore në proces dhe boshllëqeve në studime.⁶⁹ Edhe termocentrali Gacko II, i promovuar nga Elektroprivreda Republike Srpske, aktualisht kalon një proces vlerësimi mbi ndikimin mjedisor.⁷⁰

EPBiH planifikon të investojë në njësi desulfurizimi për Kakanj 6 dhe 7 dhe Tuzla 6, por kjo nuk shkon sipas pritjeve. Në fillim të vitit 2021, kompania hapi një proces tenderimi për desulfurizim për Kakanj 7,⁷¹ por në mars të vitit 2022 u hap një tender tjetër.⁷² Në fund të vitit 2021 apo fillim të vitit 2022 në mënyrë të ngjashme u krye një procedurë prokurimi për desulfurizimin e Tuzla 6,⁷³ por më pas u përsërit në fund të vitit 2022.⁷⁴

Në prill 2024 u zgjodh një konsorcium i përbërë nga Dongfang Electric International Corporation China, ITC Zenica, Fujian Lonjing Environment Technology Co. Ltd. China dhe Instituti për Ndërtim IG Banja Luka, por vendimi është kundërshtuar nga konsorciumi konkurrues, i cili pretendon favorizim ndaj ofertuesve të udhëhequr nga kompania kineze. Ajo e ka parashtruar rastin në Administratën Federale të Policisë (FUP).⁷⁵

Denitrifikimi është planifikuar edhe në Kakanj 6 dhe 7,⁷⁶ por sërish ka pak qartësi dhe progres.

Biznis Plani më i fundit i EPBiH⁷⁷ parasheh që kompania të investojë në modernizimin e Tuzla 6, 'rindërtimin' e Kakanj 7, njësi desulfurizimi në Tuzla 6 dhe Kakanj 6 dhe 7, dhe denitrifikimin në Kakanj 6 dhe 7. Por poashtu përmend një rinovim të Tuzla 4, e cila tashmë është 53 vjeç dhe duhet të ishte mbyllur sipas regjimit 'opt-out'. Së bashku me disa projekte më të vogla, këto llogariten të kushtojnë 616,4 milionë marka konvertibile boshnjake në total, ose rreth 308 milionë euro, pjesa më e madhe e të cilave duhet të vijë nga fondet e vetë kompanisë.⁷⁸ Duke pasur parasysh situatën e dobët financiare të kompanisë⁷⁹ dhe ndikimet e pritshme të Mekanizmit të Rregullimit të Kufirit të Karbonit të BE (CBAM), i cili do të fillojë në vitin 2026, kjo duket tepër optimiste.

Në korrik 2024 u shpall një njoftim tenderi për riparim të gjeneratorit në Tuzla 4.⁸⁰ Një njoftim i ngjashëm u shpall në maj 2024 për Kakanj 5,⁸¹ një njësi tjetër e cila duhej të mbyllej sipas rregullave të funksionimit të afatizuar.

⁶⁹ Rrjeti Bankwatch për EQL, [Ugljevik III lignite power plant, Bosnia and Herzegovina](#), CEE Bankwatch Network, së fundmi përditësuar në janar 2024.

⁷⁰ Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Mjedisit Jetësor e Republika Serpskës, [Decision no. 15.4.1-96-150/23](#), 22 janar 2024.

⁷¹ Akta, ['Otvoren poziv za izgradnju postrojenja za odsumporavanje u TE Kakanj, posao od 117 mil.KM'](#), Akta, 4 janar 2021.

⁷² Akta, ['Izvođenje radova na izgradnji postrojenja za odsumporavanje dimnih plinova u Termoelektrani Kakanj'](#), Akta, 3 mars 2023.

⁷³ Bosnja e Hercegovina, [LCP Emissions in 2021](#), European Environment Agency, mars 2022.

⁷⁴ Mihajlo Vujasin, ['Tender za izgradnju postrojenja za odsumporavanje u TE Tuzla otvoren do 15. Novembra'](#), Balkan Green Energy News, 3 tetor 2022.

⁷⁵ Amil Dučić, ['A criminal complaint filed against director of EPBiH and several other individuals, tenders won by Chinese are contestable'](#), Focus.ba, 26 qershor 2024.

⁷⁶ Elektroprivreda Bosne i Hercegovine, [Plan poslovanja za period 2024-2026. godina](#).

⁷⁷ Ibid.

⁷⁸ Ibid.

⁷⁹ Elektroprivreda Bosne i Hercegovine, ['Korigovan Finansijski izvještaj o poslovanju za 2023. godinu - gubitak 331 milion KM'](#), Elektroprivreda Bosne i Hercegovine, 5 korrik 2024.

⁸⁰ Elektroprivreda Bosne i Hercegovine, [Obavještenje o nabavci 986-1-2-150-3-149/24](#), Elektroprivreda Bosne i Hercegovine, 14 korrik 2024.

⁸¹ Elektroprivreda Bosne i Hercegovine, [Obavještenje o nabavci 1424-1-2-87-3-171/24](#), Elektroprivreda Bosne i Hercegovine, 28 maj 2024.

Harmonizimi me vlerat kufitare të NERP në vitin 2023

Të gjitha pesë njësitet e Kosovës që operojnë me qymyr (Kosova A3, A4 dhe A5 dhe Kosova B1 dhe B2), janë të përfshira në NERP. Viti 2023 shënoi herën e parë prej vitit 2018 që Kosova nuk shkelte më kufijtë për të tre ndotësit, por 'vetëm' ato për pluhurin dhe NO_x .

Emetimet e pluhurit kanë qenë gjithmonë problemi më i madh i vendit, por në vitin 2023 ato u rritën me 12 përqind, krahasuar me një vit më parë.


Emetimet e SO_2 ishin në nivelin më të ulët që nga viti 2018, në 10 495 tonë – vetëm 400 tonë nën vlerën kufitare. **Emetimet e NO_x** , megjithëse në nivelin më të ulët historik, **ishin 2,7 herë mbi vlerën kufitare**, të vendosur në vitin 2023 në më pak se 50 përqind të vlerës të një viti më parë.

Ndotja nga pluhuri ishte 4,86 herë mbi kufirin e nivelit kombëtar të përcaktuar në Aneksin 2⁸² të NERP, në 6 623 tonë. Në vitin 2023 vetëm dy njësitet e Kosova B tejkaluan vlerën kufitare kombëtare të pluhurit, pothuajse për katër herë, duke lëshuar gjithsej 5 934 tonë pluhur në atmosferë. **Vetëm njësia B2 emetonte 9,15 herë më shumë se vlera kufitare individuale**, duke e bërë atë emetuesin më të keq të vendit.

⁸² Ky aneks nuk është pjesë e NERP të publikuar dhe u është përcjellur si përmbajtje autorëve të këtij raporti në mënyrë joformale.

Grafiku 9:


Emetimet e pluhurit nga termocentralet me qymyr të Kosovës, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018-2023 (të dhënat e 2019 nuk janë të disponueshme)



Në vitin 2023 emetimet e SO_2 ranë në 0,96 herë nën kufirin kombëtar, ose 10 495 tonë – një rënie e konsiderueshme në krahasim me vitin paraprak, i cili arriti në 19 987 tonë. Sipas njohurive tona, nuk është instaluar asnjë pajisje de- SO_x dhe numri i orëve të punës ishte pothuajse identik me ato të vitit 2022 (vetëm Kosova B1 operoi 70 orë më shumë). Kjo vë në pikëpyetje saktësinë e emetimeve të raportuara. Me shumë mundësi, çelësi i enigmës qëndron në formulën e llogaritjes, sepse emetimet e raportuara janë në fakt vlerësime: Kosovës A i mungojnë pajisjet e monitorimit të vazhdueshëm dhe pajisjet monitoruese të Kosova B janë funksionale vetëm në intervale të rregullta testimi, ndërmjet të cilave emetimet llogariten matematikisht.

Grafiku 10:

Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentralet me qymyr të Kosovës, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018-2023 (të dhënat e 2019 nuk janë të disponueshme)



Emetimet e NO_x në Kosovë ranë ndjeshëm në krahasim me vitet e mëparshme, në nivelin më të ulët historik prej 14 851 tonësh. Meqenëse kufiri për NO_x gjithashtu u ul ndjeshëm, megjithatë vendi dallohet në rajon për shkeljen më të lartë të vlerës kufitare individuale të NO_x – 2,73 herë më shumë nga vlera e lejuar. Në nivel të njërive individuale, Kosova A4 kishte shkeljen më të lartë të vlerës individuale, duke lëshuar 4,17 më shumë nga vlera e lejuar, por të gjitha njësitë në Kosovë i kanë shkelur vlerat e tyre individuale për së paku 2 herë më shumë.


Termocentralet Kosovo A, Kosovo

Foto: Arben Llapashtica



Grafiku 11:

Emetimet e oksideve të azotit nga termocentralet me qymyr të Kosovës, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018-2023 (të dhënat e 2019 nuk janë të disponueshme)



Tipari kryesor i NERP të Kosovës është moskonzistenca ndërmjet vlerave kufitare për tre ndotësit (që edhe është paraqitur në dokumentin kryesor⁸³) dhe atyre të llogaritura në Aneksin 2 të NERP. Kjo shtojcë nuk është pjesë e NERP të publikuar dhe përmbajtja u është përcjellur autorëve të këtij raporti në mënyrë joformale.

Vlerat e SO₂ të cekura në pjesën kryesore të NERP ndjekin vetëm një ulje lineare deri në vitin 2021, dhe më pas ato rriten pak në vitet 2022 dhe 2023. Gjithashtu vlera kufitare e pluhurit shënon pak rritje në vitin 2023 – e kundërta e asaj që duhej të ndodhë. Prandaj, në këtë raport autorët kanë marrë vlerat kufitare nga Aneksi, sepse ato duken më shumë në vijë me udhëzimet e politikave të Komunitetit Energjetik lidhur me përgatitjen e NERP⁸⁴, edhe pse vlerat e pluhurit dhe NO_x janë më të larta se ato në dokumentin kryesor.

⁸³ Qeveria e Kosovës, [National Emissions Reduction Plan Kosovo](#), Energy Community, 2018.

⁸⁴ 'Vlerat kufitare për vitet 2019 deri në 2022 do të përcaktohen duke zbatuar një tendencë lineare ndërmjet vlerave të vitit 2018 dhe atyre të vitit 2023, përveç për NO_x.' Komuniteti Energjetik, [Policy Guidelines 03/2014](#), Energy Community, dhjetor 2014.

Kosova (2023)

	Vlera kufitare e SO ₂	Emetimet e SO ₂	Vlera kufitare e pluhurit	Emetimet e pluhurit	Vlera kufitare e NO _x	Emetimet e NO _x
Vlera kryesore sipas NERP	11 125	10 495	885	6 623	5 563	14 851
Aneksi 2	10 894		1 362		5 446	

Në korrik të vitit 2023, Sekretariati i Komunitetit Energjetik ndërmori hapa të mëtejshëm lidhur me procedurën e shkeljes që kishte iniciuar kundër Kosovës dhe vendeve tjera në vitin 2021, duke parashtruar një kërkesë plotësuese. Sekretariati thekson: 'Pas përfundimit të një procedure paraprake, më 13 korrik 2023, pas dështimit të Kosovës* Sekretariati i parashtrroi Këshillit të Ministrave një Kërkesë të Argumentuar lidhur me rastin ECS-8/21, për të korrigjuar shkeljen e identifikuar nga Sekretariati'.⁸⁵ Kjo u pasua nga një vendim i Këshillit të Ministrave të dhjetorit 2023,⁸⁶ që deklaronte se Kosova ishte në kundërshtim me Traktatin, së bashku me Bosnjën e Hercegovinën dhe Maqedoninë e Veriut.

Investimet aktuale për kontrollin e ndotjes

Draft-Plani Kombëtar Energjetik dhe Klimatik i Kosovës (NECP), i dorëzuar Sekretariatit të Komunitetit Energjetik në korrik të viti 2023, përforcon Strategjinë Energjetike të vendit, të publikuar një vit më parë dhe pretendon se:

Njësitë e termocentralit "Kosova B1 dhe B2" do të rinovohen për të ruajtur sigurinë e furnizimit dhe për të ulur emetimet. Rinovimi i njësive të Kosova B1 dhe B2 do të kryhet në dy faza dhe deri në fund të vitit 2025, respektivisht 2026, të dyja njësitë do të operojnë në një mënyrë më efikase, më të besueshme, duke përmbyshur standardet e detyrueshme të emetimit të parapara me Direktivën Industriale të Emetimeve.⁸⁷

Planifikimi buxhetor i Strategjisë Kombëtare Energjetike parasheh gjithsej 178 milionë euro që do të shpenzohen për rinovimin e secilës prej dy njësive të Kosovës B (Kosova B1 dhe B2) në periudhën nga viti 2023 deri në vitin 2025. Sipas NECP, një pjesë e këtyre fondeve do të sigurohen nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), ndërsa një pjesë tjetër do të mbulohet nga granti i BE. Paratë e grantit do të përdoren për të mbuluar shpenzimet për elektrofiltrat dhe de-NO_x.⁸⁸

Megjithatë, tashmë më shumë se gjashtë vjet më parë, NERP i Kosovës parashikonte që Kosova B1 do t'i nënshtrohej rikonstruksionit deri në vitin 2021,⁸⁹ në mënyrë që emetimet e pluhurit dhe NO_x të jenë në përputhje me vlerat kufitare të emetimeve sipas Direktivës Industriale të Emetimeve. Gjithashtu parashikonte që njësia B2 do të ndiqte shembullin dhe do të harmonizohej deri në vitin 2022, me përdorimin e një granti prej 76,4 milionë euro sipas Instrumentit të Para-Aderimit II të Komisionit Evropian (IPA II), të nënshkruar në nëntor të vitit 2019.

Strategjia e re energjetike e vendit, në mënyrë shqetësuese, gjithashtu përmend se një nga njësitë e Kosova A 'do të rinovohet deri në fund të vitit 2024, ndërsa vendimi për rinovimin ose heqjen e njësisë së dytë do të merret më së voni në vitin 2024'.⁹⁰ Ka disa probleme lidhur me këtë: e para është mosha e këtyre njësive – mbi 50 vjeç – dhe e dyta është se do të jetë e pamundur t'i përmbahen afatit deri në fund të vitit 2024, duke qenë se tashmë është mesi i vitit dhe publikisht nuk është regjistruar asnjë shenjë rinovimi. Përveç kësaj, kostoja e vlerësuar e investimit të kërkuar në Kosova A është 120 milionë euro për njësi, dhe kjo është shtesë e afro 178 milionë eurove të nevojshme për dy njësitë e Kosova B. Nuk është e qartë se si Kosova mund ta sigurojë këtë financim.

⁸⁵ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Case ECS-08/21](#), Energy Community, së fundmi lexuar më 5 korrik 2024.

⁸⁶ Këshilli i Ministrave i Komunitetit Energjetik, [Decision 2023/05/MC-EnC on the failure by Kosovo* to comply with the Energy Community Treaty in Case ECS-8/21](#), Energy Community, 14 dhjetor 2023.

⁸⁷ Qeveria e Kosovës, [National Energy and Climate Plan of the Republic of Kosovo 2025-2030 \(first draft version\)](#), Energy Community, 82, 2023.

⁸⁸ Ibid.

⁸⁹ Qeveria e Kosovës, [National Emissions Reduction Plan: Kosovo](#), 11.

⁹⁰ Qeveria e Kosovës, [Energy Strategy of the Republic of Kosovo 2022-2031](#), Qeveria e Kosovës, prill 2023.

Termocentrali me qymyr Pljevlja vitin e katërt me radhë shkel ligjin

Mali i Zi ka vetëm një termocentral të madh me djegie të brendshme, termocentralin e linjtit Pljevlja me 225 MWe, i cili ka vetëm një njësi. Prandaj, ai nuk mund t'i nënshtrohet një Plani Kombëtar të Zvogëlimit të Emetimeve. Në vend që të sigurohej se ishte në përputhshmëri me LCPD deri në vitin 2018, u zgjodh opsioni 'opt-out' për funksionim të afatizuar, në të cilin Pljevlja mund të operonte për një total prej 20 000 orësh ndërmjet 1 janarit 2018 dhe 31 dhjetorit 2023. Pas kësaj, siç shpjegohet më sipër, ose duhej të mbyllej ose t'i nënshtrohej një rinovimi, që së paku do ta sillte atë në vijë me vlerat kufitare të emetimeve për termocentralet e reja nga Shtojca V, Pjesa 2 e Direktivës së Emetimeve Industriale.

Sipas lejes së saj të integruar mjedisore,⁹¹ të lëshuar në mars të vitit 2018, Pljevlja duhej të harmonizohet me LCP BREF standardet më të fundit të BE deri në vitin 2023 dhe ishte termocentrali i parë ekzistues në rajon nga i cili kërkohet që ta bënte këtë.

Megjithatë, menaxhmenti i EPCG përdori shpejtë 20 000 orët që kishte në dispozicion dhe termocentrali deri në fund të vitit 2020 tashmë kishte tejkaluar këtë kufi.⁹² Por nuk u ndal me kaq, duke funksionuar plus 6 450 orë në vitin 2021 dhe 6 949 orë të tjera në vitin 2022.⁹⁴ Raporti i tij për vitin 2023 parashihte 6 949 orë pune më shumë,⁹⁵ por ka mundësi që nuk është përditësuar nga raporti i vitit paraprak.

Në prill të vitit 2021, Sekretariati i Komunitetit Energjetik hapi një rast shkeljeje kundër Malit të Zi,⁹⁶ dhe në shkurt të vitit 2023 ai parashtrroi një opinion të argumentuar,⁹⁷ pasuar nga një kërkesë e e argumentuar drejtuar Këshillit të Ministrave në korrik po të njëjtin vit.⁹⁸ Aktualisht pritet një mendim nga Komiteti Këshillues i Komunitetit Energjetik deri sa Këshilli i Ministrave të marrë një vendim për të konfirmuar shkeljen.

Siç përshkruhet në botimet e mëparshme të Përmbajit ose Mbyllit, qeveritë e njëpasnjëshme në Mal të Zi nuk kanë arritur të ndërmarrin asnjë veprim kundër termocentralit.

Emetimet në vitin 2023

Në vitin 2023, emetimet e dioksidit sulfurik në Pljevlja arritën në 44 017 tonë, pak më pak se në vitin 2022 (46 504 tonë). Por emetimet e pluhurit u dyfishuan, nga 560 tonë në vitin 2022 në 1 130 tonë në vitin 2023. Emetimet e NO_x qëndruan pothuajse të njëjta – 3 982 tonë në vitin 2023, krahasuar me 3 954 tonë një vit më parë.^{99,100}

Që nga viti 2018, tendencat kanë qenë të ndryshme për secilën nga këto tre substanca. Emetimet e SO₂ janë rritur dhe ulur, dhe arsyet nuk janë plotësisht të qarta. Ato nuk mund të kuptohen plotësisht shkak i diferencave vjetore në orët e punës.

⁹¹ [Web-faqja](#) e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor të Malit të Zi së fundmi vizituar më 24 maj 2021. Leja nuk është më online; në dispozicion është vetëm një listë masash që duhet të ndërmerren, por njoftimi për lejen është ende i hapur.

⁹² Orët e operimit nga raportet e Malit të Zi dorëzuar Agjencisë Evropiane të Mjedisit, EIONET, [Central Data Repository](#), për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

⁹³ Agjencia Evropiane e Mjedisit, EIONET, [Central Data Repository](#), EIONET, raportuar më 15 prill 2022.

⁹⁴ Agjencia Evropiane e Mjedisit, EIONET, [Central Data Repository](#), EIONET, raportuar më 13 prill 2023.

⁹⁵ Agjencia Evropiane e Mjedisit, EIONET, [Central Data Repository](#), EIONET, raportuar më 8 korrik 2023.

⁹⁶ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Secretariat launches dispute settlement procedure against Montenegro for breaching Large Combustion Plants Directive as TPP Pljevlja exhausts 'opt-out'](#).

⁹⁷ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Secretariat sends Reasoned Opinion to address non-compliance of TPP Pljevlja with the Large Combustion Plants Directive](#), Energy Community, 15 February 2023.


⁹⁸ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Case ECS 15/21: Montenegro/Environment](#), Energy Community, së fundmi lexuar më 11 korrik 2024.

⁹⁹ Agjencia Evropiane e Mjedisit, EIONET, [Central Data Repository](#), EIONET, raportuar më 8 korrik 2024.

¹⁰⁰ Agjencia Evropiane e Mjedisit, EIONET, [Central Data Repository](#), EIONET, të dhëna për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Grafiku 12:


Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentrali me qymyr Pljevlja në Malin e Zi, 2018-2023



Emetimet e NO_x ranë ndjeshëm në vitin 2019, por që atëherë kanë lëvizur rreth niveleve të ngjashme. Sërish, arsyet nuk dihen dhe nuk shpjegohen me orët e punës apo investimet e bëra.

Grafiku 13:


Emetimet e oksideve të azotit nga termocentrali me qymyr Pljevlja në Malin e Zi, 2018-2023



Nga ana tjetër, emetimet e pluhurit që nga viti 2018 kanë pasur një prirje rritëse në vend se të shënoojnë ulje dhe patën një tatëpjetë masive në vitin 2023.

Grafiku 14:

Emetimet e pluhurit nga termocentrali me qymyr Pljevlja në Malin e Zi, 2018-2023



Investimet aktuale për kontrollin e ndotjes

Që nga korriku i vitit 2024, në termocentralin Pljevlja në zhvillim e sipër është një projekt modernizimi, gjoja për ta sjellë atë në përputhje me LCP BREF standardet e BE. Në qershor të vitit 2020, qeveria e atëhershme e Malit të Zi nënshkroi një kontratë për rinovim të termocentralit me një konsorcium të udhëhequr nga kompania kineze Dongfang (DEC International), e cila përfshinte gjithashtu kompanitë lokale të lidhura mirë njëra me tjetrën (Bemaks, BB Solar dhe Permonte).¹⁰¹

Procesi është kompromituar nga parregullsi të shumta, siç edhe është paraqitur në botimet e mëparshme të Përmbaju ose Mbyll,¹⁰² dhe nuk është aspak e qartë nëse projekti do të sjellë përmirësimet e pritura. Punimet kanë nisur në prill të vitit 2022, gati dy vjet pas nënshkrimit të kontratës.¹⁰³ Atëherë përfundimi i punimeve pritej në tetor 2024. Në mars të vitit 2023 u raportua se nga Kina do të vinin paisjet që duhej instaluar, pasi që të kishin përfunduar punimet përgatitore.¹⁰⁴

Megjithatë, në qershor 2024 u raportua se pjesa e punimeve që parashihte termocentrali të jetë jashtë funksionit gjatë kësaj periudhe, do të relizohet vetëm në vitin 2025 dhe do të zgjasë shtatë muaj e gjysëm.¹⁰⁵ Arsyet e vonësës nuk janë plotësisht të qarta, por një ndërprerje kaq e gjatë e planifikuar padyshim që nuk mund të ndodhë në periudhat e pikut të kërkesës.

Që nga momenti kur u nënshkrua kontrata me Dongfang në vitin 2020, organizatat e shoqërisë civile vunë në dyshim mungesën e një studimi fizibiliteti për projektin e modernizimit.¹⁰⁶ Termocentrali është ndërtuar në vitin 1982, kështu që funksionimi i tij i mëtejshëm do të jetë i kufizuar dhe nuk është e qartë nëse instalimi i pajisjeve të shtrenjta të desulfurizimit do të shpagohet. Procedura e tenderimit gjithashtu ngjalli dilema pasi ofertuesve nuk u kërkonte të shpjegonin se cilën zgjidhje teknike do të përdornin, por vetëm të respektonin vlerat kufitare të emetimeve. Oferta e Dongfang ishte dukshëm më e ulët se ajo e konsorciumeve konkurruese dhe një prej tyre, Hamon-Rudis, vuri në dyshim nëse ishte e mundur të arrihej ky qëllim me një ofertë kaq të ulët.¹⁰⁷

¹⁰¹ Balkan Green Energy News, 'EPCG signs agreement on TPP Pljevlja environmental overhaul', *Balkan Green Energy News*, 10 qershor 2020.

¹⁰² Rrjeti Bankwatch për Evropën Qendrore dhe Lindore, [Comply or Close](#).

¹⁰³ Vladimir Spasiq, 'EPCG započela ekološku rekonstrukciju TE Pljevlja', *Balkan Green Energy News*, 24 prill 2022.

¹⁰⁴ Sasha Bezareviq, 'Stiže oprema iz Kine, rekonstrukcije Termoelektrane Pljevlja pri kraju', *RTCG*, 4 mars 2023.

¹⁰⁵ FOS Media, 'Rekonstrukcija TE Pljevlja neće uticati na povećanje cijene struje', *FOS Media*, 16 qershor 2024.

¹⁰⁶ Radio Televizioni i Malit të Zi, 'Objaviti studiju ekonomske opravdanosti rekonstrukcije TE Pljevlja', *Radio Televizija Crne Gore*, 24 korrik 2020.

¹⁰⁷ Pipa Galop, 'NGOs expect Energy Community infringement procedure on Montenegrin coal plant', *CEE Bankwatch Network*, 19 prill 2021.

Doli që Hamon-Rudis kishte të drejtë, pasi çmimi i projektit u rrit më vonë në 70 milionë euro për shkak të punimeve rreth përshtatjes së bojlerit.¹⁰⁸ Muajt e fundit në media janë përmendur 80 milionë euro.¹⁰⁹ Mbetet të shihet se cili do të jetë çmimi përfundimtar dhe nëse termocentrali 42-vjeçar më tutje do të jetë në gjendje t'i përmbushë LCP BREF standardet e BE.

Që nga fundi i korrikut 2024, Mali i Zi ende nuk ka publikuar asnjë draft të NECP, dhe data e tij e heqjes së qymyrit nga përdorimi mbetet e paqartë. Në qershor të vitit 2021, Mali i Zi njoftoi se do të largojë përdorimin e qymyrit më së voni deri në vitin 2035,¹¹⁰ por në realitet kjo pritet të ndodhë më herët. Nga 1 janari 2026, eksportet e energjisë elektrike në Itali, të mundësuar nga hapja e një kabloje nënujore në fund të vitit 2019, mund të ulen për shkak të tarifave të CBAM, duke e privuar termocentralin nga një burim fitimprurës të ardhurash. Mali i Zi mund t'i shmangë këto, midis tjerash, duke rritur çmimin e tij të karbonit në nivelin e Sistemit të Tregtimit të Emetimeve të BE deri në vitin 2030, që do të thotë se do t'i duhet që gradualisht ta rrisë çmimin minimal aktual prej 24 euro për ton.

Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një vend të vogël, do të duheshin vetëm edhe disa ferma diellore dhe me erë që do të bëjnë ndryshim të madh për të mbuluar kërkesën për energji elektrike të Malit të Zi, por viteve të fundit progresi ka qenë i ngadalshëm.

Panelet diellore nëpër kulme kanë marr hov falë projektit Solari të kompanisë publike të energjisë elektrike Elektroprivreda Crne Gore (EPCG), e cila deri në shkurt 2024 instaloi 30 MW,¹¹¹ por feramat solare që mund të bëjnë ndryshim pozitiv ecin me një dinamikë të ngathët, me impiantin e parë prej 4,42 MW i cili filloi funksionimin vetëm në dhjetor të vitit 2023.¹¹² Në vitin 2024 janë planifikuar vetëm 8,7 MW më shumë energji diellore nga ferma solare, por 30 deri në 100 MW energji diellore shtesë priten nga panelet e kulmeve nga projekti Solari.¹¹³ Që nga viti 2019 nuk ka filluar të funksionojë asnjë fermë e re me erë, megjithëse sipas EPCG, ndërtimi i fermës së erës Gvozd duhej të kishte filluar deri para publikimit të këtij raporti.¹¹⁴

¹⁰⁸ Elektroprivreda Crne Gore deklaroi se EUR 15 milion plotësues ishte për një projekt tjetër për sa i përket adaptimit të bojlerit, por pranoi se ishte ngushtë i lidhur me projektin e modernizimit. Drashko Milačiq, ["Rekonstrukcija Termoelektrana će koštati oko 70 miliona"](#), Dan, 18 dhjetor 2021.

¹⁰⁹ Radio Televizioni i Malit të Zi, ["Gradane Pljevalja čeka bolja i zdravlja budućnost"](#), Radio Televizija Crne Gore, 6 mars 2024.

¹¹⁰ Balkan Green Energy News, ["Montenegro announces coal phaseout by 2035"](#), Balkan Green Energy News, 1 korrik 2021.

¹¹¹ Elektroprivreda Crne Gore, ["EPCG Solar gradnja predstavila se na Balkan solar samitu u Banja Luci"](#), EPCG Solar Gradnja, 12 shkurt 2024.

¹¹² Ekovjesnik, ["S radom počela prva solarna elektrana u kopnenom dijelu Crne Gore"](#), Ekovjesnik, 27 dhjetor 2023.

¹¹³ Qeveria e Malit të Zi, ["Prijedlog odluke o Energetskom bilansu Crne Gore za 2024. godinu"](#), Government of Montenegro, 16 nëntor 2023.

¹¹⁴ Elektroprivreda Crne Gore, ["Đukanović: Gradićemo i vjetroelektranu "Gvozd 2"](#), Elektroprivreda Crne Gore, 15 maj 2024.

Termocentralet Pljevalja, Mali i Zi
Foto: CEE Bankwatch Network



Maqedonia e Veriut

Harmonizimi me vlerat kufitare të NERP në vitin 2023

NERP i Maqedonisë së Veriut u miratua në vitin 2017, pa asnjë konsultim publik ose një vlerësim strategjik mjedisor. Ai përfshin të tetë termocentralet e mëdha ekzistuese me djegie të brendshme nga sektori energjetik, nga të cilat tre janë me qymyr, një përdor naftë industriale dhe dy janë termocentralet ngrohjeje me gaz fosil që kanë qenë të paktën pjesërisht funksionale gjatë periudhës së zbatimit të planit. Dy impiantet tjera janë ngrohtore në rafinerinë e vjetër të naftës, e cila edhe pse nuk është mbyllur zyrtarisht, ka më shumë se dhjetë vjet që nuk funksionon.

Gjatë gjashtë viteve që nga kalimi i afatit të harmonizimit me LCPD, suksesi i vetëm i vendit është se largua edhe më shumë nga harmonizimi, si në reduktimin e emetimeve, ashtu edhe në pjesën e monitorimit. Asnjë nga termocentralet me qymyr ende nuk ka monitorim të vazhdueshëm dhe deri më tani ata kanë raportuar vetëm në bazë të përllogaritjeve nga matjet e bëra një herë në muaj.

Në vitin 2023, situata u përkeqësua më shumë. Për shkak se monitorimi mujor ishte jo i besueshëm dhe tregoi variacione të mëdha në matje, autoritetet përdorën faktorët e emetimeve nga vitet 2020, 2021 dhe 2022, në kombinim me inputin e energjisë termike në teraxhul, për të gjeneruar një vlerësim të emetimeve nga djegia e qymyrit. Megjithatë, gjasat janë të vogla që këto vlerësime t'i paraqesin emetimet reale me saktësi.

Kjo ndodh sepse inputi i energjisë nuk është i vetmi faktor i rëndësishëm për emetimet: përbërja kimike e linjtit (përmbajtja e squfurit, lagështia, etj.) luan gjithashtu një rol të rëndësishëm. Pothuajse një e treta e gjashtë milionë tonëve linjit të nevojshëm për funksionimin e termocentralit në Manastir është importuar në vitin 2023. Importi është bërë përmes tri kompanive të ndryshme, nga miniera të ndryshme të qymyrit në rajon.¹¹⁵ Duke marrë parasysh këtë, përdorimi i faktorëve të nënkuptuar të emetimeve nga vitet e mëparshme është i dobishëm vetëm nëse karakteristikat e karburantit dhe efikasiteti i zvogëlimit janë shumë të qëndrueshme. Prodhimi i energjisë dhe emetimet e lidhura me to nuk mund të llogariten thjesht pa marrë në konsideratë, në mënyrë proporcionale, karakteristikat e ndryshme të karburantit nga qymyri i importuar.

Përveç kësaj, ndërmarrja publike e energjisë elektrike Elektrani na Severna Makedonija (AD ESM) nuk ka bërë asnjë investim në kontrollin e ndotjes për termocentralet me qymyr që nga viti 2013, kur njësitë Bitola 2 dhe 3 u rinovuan për të reduktuar emetimet e NO_x. Si pasojë, që nga fillimi i raportimit për NERP në vitin 2018, emetimet e SO₂ janë dyfishuar, ndërsa ato të pluhurit, megjithëse luhateshin pak për shkak të ndryshimeve në orët e punës, prapëseprapë ishin më të larta në vitin 2023 sesa në vitin 2018.

¹¹⁵ Sërgjan Stojančev, 'Промена на планот на ЕСМ – помалку ископ, повеќе увоз на јаглен'.


Maqedonia e Veriut (2023)

Vlera kufitare e SO ₂ ⁵¹	Emetimet e SO ₂	Vlera kufitare e pluhurit	Emetimet e pluhurit	Vlera kufitare e NO _x	Emetimet e NO _x
15 855	101 331	1 738	3 849	8 422	4 725

Emetimet e SO₂ nga djegia e qymyrit në vitin 2023 ishin pak më të ulëta se në vitin 2022, por mbetën jashtëzakonisht të larta (101 331 tonë) dhe ishin 6,4 herë më shumë se kufiri kombëtar prej 15 855 tonësh.

Grafiku 15:

Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentralet me qymyr të Maqedonisë së Veriut, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018-2023



Individualisht, oxhaqet e Bitola B1, B2 dhe B3 emetuan 69 998 dhe 29 067 tonë, përkatësisht 10 herë më shumë se vlerat e tyre individuale. Si në vitet e mëparshme, këto dy së bashku kontribuan me më shumë se 95 përqind të emetimeve totale të raportuara të SO₂ në Maqedoninë e Veriut. Kontributi i Oslomej ishte 2 266 tonë – brenda kufirit të tij individual, por vetëm për shkak të orëve të kufizuara të funksionimit.


Në vitin 2023 emetimet e pluhurit nga prodhimi i energjisë me qymyr shënuan pak rënie, krahasuar me vitin 2022, por me 3 849 tonë, ato mbeten më shumë se dy herë më të larta se kufiri kombëtar prej 1 738 tonësh.

Termocentralet Bitola, Maqedoni e Veriut

Foto: CEE Bankwatch Network

Grafiku 16:

Emetimet e pluhurit nga termocentralet me qymyr të Maqedonisë së Veriut, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018-2023




Bitola B1 dhe B2 kontribuan me 2 582 tonë pluhur dhe Bitola B3 me 974 tonë. Në total, termocentrali emeton tre herë më shumë se vlerat kufitare individuale të njësive së bashku dhe mbetet arsyeja kryesore pse vendi në tërësi nuk është në përputhshmëri me kufirin e tij të emetimeve të pluhurit. Ashtu si me SO₂, Oslomej është harmonizuar me emetimet e pluhurit prej 293 tonësh, vetëm për shkak të orëve të ulëta të punës.

Emetimet e raportuara të NO_x në Maqedoninë e Veriut tregojnë një rënie prej rreth 20 përqind në krahasim me vitin 2022, por duke pasur parasysh se ishte viti më i keq i regjistruar për NO_x, kjo ishte disi e pritshme. 4 725 tonë të emetuar në vitin 2023 janë të krahasueshme me 4 708 tonë në vitin 2018 dhe brenda kufijve të NO_x për vitet 2023 dhe 2027.

Termocentralet Bitola, Maqedoni e Veriut
Foto: CEE Bankwatch Network

Grafiku 17:

Emetimet e NO_x nga termocentralet me qymyr të Maqedonisë së Veriut, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018-2023



Në mars të vitit 2021, për shkak të shkeljeve të vlerave kufitare të përgjithshme të NERP, Sekretariati i Komunitetit Energjetik ngriti një kontest kundër Maqedonisë së Veriut, së bashku me rastet kundër vendeve të tjera. Më 13 korrik 2023, Sekretariati i paraqiti Këshillit të Ministrave një kërkesë të argumentuar për të marrë një vendim që konfirmonte mosharmonizimin, gjë që këshilli e bëri në dhjetor të vitit 2023.¹¹⁶ Meqenëse shkeljet nuk janë korrigjuar, në fund të korrikut 2024 çështja akoma mbetet hapur.¹¹⁷

Investimet aktuale për kontrollin e ndotjes

Që nga dhjetori i vitit 2022 kanë kaluar gati dy vjet që nga lëshimi i lejes për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (IPPC) për termocentralin Bitola, e ende nuk ka as edhe një sinjal investimesh për kontrollin e ndotjes. Duke marrë parasysh afatet ligjore për tenderim dhe kohën e nevojshme për zbatimin e këtyre investimeve komplekse, tani është e pamundur që termocentrali të bëjë një riparim të plotë të filtrave elektrostatikë deri në dhjetor 2025 ose ndërtimin e një objekti desulfurizimi deri në dhjetor 2026, siç parashihet në lejen e dhënë. Këto investime gjithsesi kanë pak kuptim, duke pasur parasysh se Maqedonia e Veriut planifikon të heqë qymyrin më së voni deri në vitin 2030, por kjo nuk e ndryshon faktin që termocentrali vazhdon të shkelë të gjitha detyrimet kombëtare dhe të Traktatit të Komunitetit Energjetik, dhe për këtë duhet të penalizohet.

Në vend që të bëjë investimet e nevojshme për të mbajtur funksionimin e termocentralit brenda kufijve ligjorë, SH.A. ESM investon në hapjen e minierave të reja të linjitit. Miniera e planifikuar e Zhivojnos pranë Manastirit ende nuk ka një vlerësim të ndikimit mjedisor, por kompania tashmë ka filluar me tenderët për infrastrukturën rrugore të nevojshme për të sjellë linjitin nga miniera e re në termocentral.¹¹⁸ Në të njëjtën kohë, është duke menduar edhe hapjen e një miniere të re të linjitit në afërsi të Oslomejit, në lokacionin e quajtur Gushtericë dhe në mars 2024 i akordoi tender një kompanie për përpilimin e *Studimit mbi arsyeshmërinë e koncesionit për shfrytëzimin e lëndës së parë minerale – qymyr në rezervuarin e Gushtericës*.¹¹⁹

Hapat e ndërmarrë nga SH.A. ESM tregojnë se ajo nuk e merr seriozisht detyrimin për heqjen graduale të qymyrit nga përdorimi, e në të njëjtën kohë i shmanget çdo investimi për uljen e ndotjes jashtëzakonisht të lartë nga termocentralet. Kjo është e paqëndrueshme: termocentralet duhet t'u përmbahen standardeve dhe të mbyllen.

¹¹⁶ Këshilli i Ministrave i Komunitetit Energjetik, [Decision 2023/04/MC-EnC on the failure by the Republic of North Macedonia to comply with the Energy Community Treaty in Case ECS-7/21](#), Energy Community, 14 dhjetor 2023.

¹¹⁷ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Case ECS 07/21, North Macedonia/Environment](#), Energy Community, së fundmi lexuar më 26 korrik 2024.

¹¹⁸ Sistemi elektronik për prokurime publike, [Announcement for public procurement for a basic project for road infrastructure to transport coal from Zivojno to REK Bitola](#), 20 dhjetor 2023.

¹¹⁹ Sistemi elektronik për prokurime publike [Announcement for public procurement for a Study on the justification of the concession for the exploitation of mineral raw materials - coal at the Gusterica deposit](#), 25 mars 2024.

Maqedonia e Veriut është vendi më i avancuar në rajon për sa i përket planifikimit lidhur me transformimin e energjisë dhe tranzicionin e drejtë, por veprimet e qeverisë dhe SH.A. ESM nuk janë në vijë me dokumentet e saj strategjike. Meqenëse vendi tashmë ka një Udhërrëfyes për Tranzicion të Drejtë¹²⁰ dhe një Plan Investimi për përshpejtimin e tranzicionit të qymyrit,¹²¹ duhet të fillojë të investojë në ato procese në vend të kapaciteteve të reja të qymyrit dhe të shmangë vonesat e mëtejshme lidhur me datën e heqjes të qymyrit nga përdorimi. Investitorët privatë tashmë bëjnë investime të konsiderueshme në termocentrale fotovoltaike dhe të erës, por SH.A. ESM ngel prapa duke iu përmbajtur politikave të vjetra.

Në rishikimet e ardhshme të strategjisë energjetike dhe NECP, vendi duhet të riafirmojë angazhimin e tij për të hequr gradualisht qymyrin nga përdorimi brenda afatit kohor tashmë të rënë dakord. Ndërkohë, duhet të vazhdojë punën për krijimin e një mjedisi që do të mundësojë një kalim më të shpejtë drejt energjisë së rinovueshme, me fokus të theksuar në decentralizimin dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Serbia

Harmonizimi me vlerat kufitare të NERP në vitin 2023

Në nëntor të vitit 2022,¹²² në një rast të iniciuar nga Instituti Rregullator i Energjisë së Rinovueshme dhe Mjedisit (RERI), Gjykata e Lartë në Beograd urdhëroi ndërmarrjen shtetërore të energjisë Elektroprivreda Srbije (EPS) të sjellë emetimet e SO₂ nga të gjitha termocentralet e saj me qymyr në vijë me vlerat e parapara në NERP-in e vendit. Në mars të vitit 2023 gjykata hodhi poshtë ankesën e EPS; megjithatë, EPS nuk ka ndërmarrë asnjë veprim të dukshëm për të përshpejtuar rehabilitimin e termocentraleve të qymyrit ose për të mbyllur emetuesit më të këqij, madje ka ndodhur e kundërta.

Në vitin 2023, emetimet e SO₂ nga NERP termocentralet me qymyr në Serbi u rritën në krahasim me dy vitet e mëparshme. Emetimet e pluhurit mbetën nën vlerën kufitare dhe kanë tendencë rënieje të ngadalshme, ndërsa emetimet e NO_x u rritën në krahasim me vitin 2022 dhe për herë të parë tejkaluan kufirin e përcaktuar.

SO₂ emissions from the NERP coal plants are a major problem in Serbia. In a Emetimet e SO₂ nga termocentralet me qymyr të përfshira në NERP janë një problem i madh në Serbi. Në vitin 2023, ata emetuan 5,4 herë më shumë SO₂ sesa lejohej me kufirin e paraparë në NERP.

Në shifra absolute, emetimet e SO₂ të 14 njësive me qymyr të përfshirë në NERP arritën në 296 011 tonë; për 18 termocentrale të mëdha me djegie të brendshme vlera kufitare për vitin 2023 në NERP¹²³ është vendosur në një maksimum prej 54 575 tonësh.

Kjo është pak më e ulët se në periudhën 2018-2020, por më e lartë se në 2021 dhe 2022. Në vitin 2022, shkëlja për SO₂ ishte 4,8 herë më e lartë se vlera kufitare. U 2022. prekoraçenja za SO₂ je bilo 4,8 puta veće od maksimalnih vrijednosti.

¹²⁰ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, [Just Transition Roadmap](#), Government of the Republic of North Macedonia, maj 2023.

¹²¹ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, [Accelerating Coal Transition Investment Plan for the Republic of North Macedonia – Pelagonia and Southwest regions](#), Government of the Republic of North Macedonia, janar 2024.


¹²² Instituti Rregullator i Energjisë së Rinovueshme dhe Mjedisit (RERI), ['Historic ruling: Serbia's state energy supplier must slash toxic plant emissions nationwide'](#), Renewables and Environmental Regulatory Institute (RERI), nëntor 2022.

¹²³ NERP poashtu përfshin njësi me gaz, si ato në pronësi të NIS në Novi Sad dhe Pançevë, si dhe një rafineri. Ministria për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor e Serbisë, [Nacionalni plan za smanjenje emisija glavnih zagađujućih materija koje potiču iz starih velikih postrojenja za sagorjevanje](#), Shtojca 2, Ministry for Environmental Protection of the Republic of Serbia, shkurt 2020.

Termocentralet Kostolac B, Serbia
Foto: CEE Bankwatch Network

Grafiku 18:

Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentralet me qymyr të Serbisë, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018-2023



Në nivel termocentrali, rritja më befasuese ishte në termocentralin Nikola Tesla B (B1 dhe B2), e cila funksionoi vetëm për 58 orë më shumë se në vitin 2022, por SO₂ emetimet u rritën nga 73 012 tonë në 92 260 tonë, duke e bërë kështu emetuesin e dytë më të keq absolut të SO₂ në rajon, pas Ugljevikut.

Nikola Tesla B u pasua nga Nikola Tesla A4-A6, i cili emetoi 58 551 tonë.¹²⁴ Kostolac A2 emetoi 28 132 tonë, ose 10,52 herë më shumë SO₂ sesa lejohej nën vlerën e lejuar individuale, gjë që e bëri atë shkelësin më të keq të vendit për sa i përket shkeljeve individuale të vlerave kufitare.

Edhe pse në janar të vitit 2023 pajisja për desulfurizim e Kostolac B më në fund mori një leje operimi,¹²⁵ ajo vetëm pak lehtësoi rrethanat. Po atë vit, ky termocentral emetoi 45 803 tonë SO₂ – gati 10 000 tonë më shumë se në vitin 2022, edhe pse me numër të ngjashëm orësh pune. Kjo përfaqësonte 5,76 herë më shumë sesa lejohej të emetonte me vlerën individuale të përcaktuar në NERP.

Leja operative për trajtimin e ujërave të zeza nga de-SO_x u dha vetëm në maj 2024, gjë që mund të ndihmojë në shpjegimin e asaj se përse termocentrali i desulfurizimit nuk funksiononte rregullisht. Mbetet për t'u parë nëse do ta bëjë këtë tani.


Emetimet e pluhurit janë brenda kufirit kombëtar të NERP të Serbisë dhe kanë rënë gradualisht që nga viti 2018. Megjithatë, në vitin 2023 Kostolac A2 emetoi 1,5 herë më shumë se kufiri i tij individual, ndërsa Nikola Tesla A1-A3 emetoi mbi 1,4 herë më shumë nga vlera e lejuar. Ngrohitorja Vreoci ka tejkaluar edhe kufirin individual, duke emetuar 2,9 herë më shumë nga vlera e lejuar.

¹²⁴ Agjencia Evropiane e Mjedisit Jetësor, [EIONET Central Data Repository](#), European Environment Agency, 30 mars 2024. Të dhënat akoma nuk janë verifikuar nga Agjencia Evropiane e Mjedisit Jetësor.

¹²⁵ Ministria e Ndërtimit, Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Serbisë, [Operating permit de-SO_x](#), Ministry of Construction, Transport and Infrastructure of the Republic of Serbia, 11 janar 2023.

Grafiku 19:

Emetimet e pluhurit nga termocentralet me qymyr të Serbisë, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018-2023



Emetimet e NO_x në Serbi shënuan një rritje të lehtë në vitin 2023, krahasuar me tendencën rënëse të vërejtur në të gjitha vitet e mëparshme. E kombinuar me një ulje të vlerave të përgjithshme, kjo rezultoi në një shkelje të vlerës kufitare të NO_x , me emetime deri në 1,13 herë më shumë nga që lejohej. Me këtë ritëm, Serbisë mund t'i hapet një procedurë e re shkeljeje nga Sekretariati i Komunitetit Energjetik për mospërputhje me vlerë kufitare individuale të NO_x , si shtesë kontestit ekzistues të hapur në vitin 2021 për mospërputhje me vlerë e saj kufitare të SO_2 .¹²⁶

Për sa i përket njësive individuale, shkelësi më i keq për NO_x në terma absolutë ishte termocentrali Nikola Tesla B (njësitë B1 dhe B2), me 11 633 tonë të emetuara – 1,4 herë më shumë se kufiri individual. Njësitë A3-A6 të Nikola Tesla A emetuan shumë më pak (6 348 tonë), por gjithsesi tejkaluan vlerën kufitare të termocentralit. Së bashku, këto ishin të mjaftueshme për ta sjellë vendin në mospërputhje me kufijtë e tij NERP për NO_x .


¹²⁶ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Case ECS 10/21, Energy Community](#), së fundmi lexuar më 10 korrik 2024.

E imja Drmno, Serbia

Foto: CEE Bankwatch Network

Grafiku 20:

Emetimet e oksideve të azotit nga termocentralet me qymyr të Serbisë, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018-2023



Serbia (2023)

Vlera kufitare e SO ₂ ⁵¹	Emetimet e SO ₂	Vlera kufitare e pluhurit	Emetimet e pluhurit	Vlera kufitare e NO _x	Emetimet e NO _x
54 575	296 011	6 390	4 492	27 105	30 625

Fitimet rekorde të EPS¹²⁷ të paguara me shëndetin e banorëve

Krahasuar me vitin 2022, kur Serbia u godit nga një krizë e shumfishtë energjetike – ndërprerje të paplanifikuara të termocentraleve, probleme me furnizim qymyri, burime të ulëta hidrologjike – vitin e kaluar EPS kishte një fitim të jashtëzakonshëm prej afro 1 miliard euro.¹²⁸ Menaxhmenti i ri i EPS ia atribuon këtë hidrologjisë së favorshme, çmimeve më të ulëta të importit të qymyrit, çmimeve më të larta të shitjes së energjisë elektrike dhe përmirësimeve të efikasitetit operacional.¹²⁹ Por realiteti është se funksionimi i paligjshëm i termocentraleve me regjim pune të afatizuar, mospërdorimi i pajisjeve de-SO_x në Kostolac B, mungesa e çmimit të karbonit dhe dështimi i përgjithshëm për të përvetësuar kostot e ndotjes së mjedisit jetësor dhe rrezikimit të shëndetit të njeriut, lënë përshtypjen e një biznesi fitimprurës.

Në vitin 2023 Serbia mbajti në punë termocentralin e saj të vjetër Morava për 3 867 orë plus, duke shkelur afatin për mbyllje. Për këtë arsye në qershor të vitit 2023, RERI dhe Bankwatch parashtruan një ankesë¹³⁰ në Sekretariatit e Komunitetit Energjetik dhe në tetor të vitit 2023 Sekretariati ngriti kontest kundër Serbisë.¹³¹

Përveç kësaj, deri në fund të vitit 2023, Serbia kishte shkelur afatin e mbylljes së dy njësive tjera në termocentralin Kolubara. Të dyja njësitë A3-1 dhe A3 3-5 së bashku kishin pak më shumë se 1 000 orë pune në fund të vitit 2022,¹³² dhe të dyja punuan përtej afatit të përcaktuar deri në fund të vitit 2023, duke shtuar 3 215, përkatësisht 2 829 orë. Kolubara A5 nuk i përdori të gjitha 20 000 orët deri në fund të vitit 2023, por gjithsesi do të mbyllej për shkak të skadimit të afatit për mbyllje.

¹²⁷ Vladimir Spasiq, 'Serbia's EPS posts record EUR 1 billion profit for 2023', *Balkan Green Energy News*, 20 mars 2024.

¹²⁸ Ibid.

¹²⁹ Elektroprivreda Srbije, *Izveštaj o realizaciji trogodišnjeg plana poslovanja Grupe EPS za period 01.01.-31.12.2023.*, Elektroprivreda Srbije, shkurt 2024.

¹³⁰ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, *Case ECS-09/23, Energy Community*, së fundmi lexuar më 10 korrik 2024.

¹³¹ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, *'Secretariat launches dispute settlement procedure against Serbia for breaching the Large Combustion Plants Directive in the case of TPP Morava'*.

¹³² Sekretariati i Komunitetit Energjetik, *Serbia Annual Implementation Report 2023, Energy Community*, 12, nëntor 2023.

Në fillim të vitit 2023, EPS njoftoi se do të mbyllte termocentralet Kolubara dhe Morava vetëm në fund të vitit 2024,¹³³ por më vonë e zgjati këtë deri në vitin 2026.¹³⁴

Pas një kërkesë ligjore që organizata RERI i drejtoi Inspektoratit të Mjedisit pranë Ministrisë së Mbrojtjes së Mjedisit Jetësor për të kryer inspektime të jashtëzakonshme, janë bërë vizita të shumta dhe inspektorati ka konstatuar se Morava dhe Kolubara A shkelin vlerat kufitare përkatëse të emetimeve dhe operojnë në mënyrë të paligjshme, duke tejkaluar 20 000 orë. Inspektorati urdhëroi që të ndërmerren masa për të respektuar vlerat kufitare, por EPS nuk zbatoi urdhërin. Prandaj, në tetor të vitit 2023, Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit Jetësor informoi Ministrinë e Minierave dhe Energjisë për shkeljet dhe i kërkoi asaj të zbatonte Traktatin e Komunitetit Energjetik.

Investimet aktuale për kontrollin e ndotjes

Gjatë vitit 2023, njësia e desulfurizimit në Kostolac B1 dhe B2 mbeti i vetmi instalim i tillë i Serbisë, por siç u përkthyer më lart, performanca e saj duket të jetë një dështim, duke pasur parasysh se termocentrali ende emetonte 5,76 herë më shumë SO₂ se kufiri i tij individual. Nga 1 janari 2028 e në vazhdim, termocentrali duhet të jetë harmonizuar me vlerat më strikte kufitare të emetimeve sipas Direktivës për Emetimet Industriale, diçka që për momentin duket shumë e pamundur.

Në prill 2024, u raportua se njësia e desulfurizimit në Nikola Tesla A3-A6 në vlerë prej 215 milionë eurosh ishte vënë në funksion,¹³⁵ 13 vjet pas sigurimit të fondeve.¹³⁶ Nga përvoja e Kostolac B, mbetet për t'u parë se çfarë realisht do të thotë kjo për emetimet SO₂ të termocentralit.

Në dhjetor 2020 filluan punimet për instalimin e pajisjeve të desulfurizimit në Nikola Tesla B – emetuesi i dytë më i madh i SO₂ në vend pas Kostolac B – me një afat kohor realizimi deri në vitin 2024.¹³⁷ Megjithatë, vlerësimi i ndikimit të tij mjedisor u miratua vetëm në mars të vitit 2022.¹³⁸ Në fund të këtij viti EPS raportoi se punimet ishin 60,52 përqind të përfunduara,¹³⁹ ndërsa në prill 2024 u raportua se përfundimi i tij pritet vetëm në fund të vitit 2025.¹⁴⁰

Për Kostolac A, në tetor të vitit 2020 EPS shpalli thirrje për studim fizibiliteti për një instalim desulfurizimi,¹⁴¹ me synimin për të zgjidhur afatin e operimit të termocentralit për 15 vite.¹⁴² Megjithatë, në vitin 2022 kompania rishqyrtoi këtë vendim dhe anonte drejt një mbylljeje,¹⁴³ siç ishte, në fakt, plani origjinal kur në vitin 2016 NERP u hartua për herë të parë. Në vitin 2023, u njoftua se termocentrali do të mbyllet në fund të vitit 2028.¹⁴⁴ Për shkak të mungesës së investimeve për kontrollin e ndotjes, janë të vogla gjasat që emetimet e tij të ulen para këtij afati. Gjithashtu ekziston rreziku që, ashtu si Morava dhe Kolubara A, mbyllja e saj të vonohet, duke bërë më tej edhe më shumë shkelje të ndotjes.

Sa i përket oksideve të azotit, në Kostolac B2 janë bërë disa lëvizje, me vendosjen e një sistemi për masat parësore, i instaluar në vitin 2019, dhe një rezervuar për amoniak si masë dytësore, i instaluar në vitin 2023.¹⁴⁵ Rezultatet nuk janë ende të njohura.

Megjithëse EPS në termocentralet e saj gradualisht instalon pajisje për kontrollin e ndotjes, në përgjithësi projektet ose kanë qenë joefektive, si me de-SO_x në Kostolac B, ose janë disa hapa prapa realitetit ligjor dhe ekonomik. Në vitin 2023, EPS prezantoi planin e quajtur Go Green Road,¹⁴⁶ i cili duket se përfshin planet e mbylljes për disa nga njësitë më të vogla dhe më të vjetra, por deri në fund të korrikut 2024 ai ende nuk është publikuar.

Mirëpo për njësitë e saj më të mëdha, ajo ka investuar shuma të mëdha fondesh për desulfurizim. Nga njëra anë kjo është e nevojshme pasi këto termocentralet nuk mund të mbyllen menjëherë dhe nuk mund të vazhdojnë të ndotin në nivelet aktuale. Por gjithashtu ato janë të shtrenjta dhe shpenzojnë mjaftueshëm energji, duke i bërë kështu termocentralet edhe më pak efikase. EPS sigurisht që do të paguajë çmimin për shfrytëzimin e ngadalshëm të erës dhe diellit, pasi qymyri bëhet gjithnjë e më pak konkurrues sapo të vendoset CBAM ose një çmim alternativ karboni.

Është e paqartë nëse Serbia në tërësi ka një plan për ta adresuar këtë çështje, pasi drafti i NECP, i botuar në mesin e vitit 2023, ishte i cilësisë së dobët dhe i vështirë për t'u kuptuar.¹⁴⁷ NECP përfundimtar u miratua në fund të korrikut 2024, por deri më 29 korrik nuk ishte i disponueshëm për publikun.

¹³³ Vladimir Spasiq, 'EPS sets out plan for shutting down coal power plants',

¹³⁴ Elektroprivreda Srbije, 'Трогодишњи план пословања Акционарског друштва „Електропривреда Србије“, Београд за период 2024-2026.г. - ИЗВОД', Elektroprivreda Srbije, janar 2024.

¹³⁵ Igor Todorović, 'Mitsubishi Power commissions desulfurization system in Serbia's TENT A coal plant',

¹³⁶ Svetlana Jovanović, 'Construction launched on flue-gas desulfurization systems at coal-fired power plant TENT A', Balkan Green Energy News, 14 shkurt 2019.

¹³⁷ Vladimir Spasiq, 'SO₂ emissions from Nikola Tesla B coal plant to be reduced 20 times by 2024', Balkan Green Energy News, 2 dhjetor 2020.

¹³⁸ Elektroprivreda Srbije, '2023 Environmental Report', Elektroprivreda Srbije, 77, prill 2024.

¹³⁹ Ibid.

¹⁴⁰ Igor Todorović, 'Mitsubishi Power commissions desulfurization system in Serbia's TENT A coal plant',

¹⁴¹ Nina Domazet, 'EPS namjerava proizvesti život TE Kostolac A', Energetika-net, 19 tetor 2020.

¹⁴² Vladimir Spasiq, 'EPS plans to extend lifespan of TPP Kostolac A until 2038', Balkan Green Energy News, 15 tetor 2020.

¹⁴³ Vladimir Spasiq, 'EPS considering shutdown of coal power plant Kostolac A', Balkan Green Energy News, 29 korrik 2022.

¹⁴⁴ Vladimir Spasiq, 'EPS sets out plan for shutting down coal power plants',

¹⁴⁵ Elektroprivreda Srbije, '2023 Environmental Report', 77.

¹⁴⁶ Vladimir Spasiq, 'EPS sets out plan for shutting down coal power plants',

¹⁴⁷ Pipa Gallop, 'Serbia's draft NECP: What is the actual plan?', CEE Bankwatch Network, 17 korrik 2023.

Konkluzat dhe rekomandime

Nivelet e ndotjes nga termocentralet me qymyrit të Ballkanit Perëndimor gjashtë vjet pas afatit për zbatimin e LCPD mbeten jashtëzakonisht të larta.

Në vitin 2023, emetimet e të tre ndotësve sërish shkelën vlerat kufitare të përcaktuara në NERP-ët e Bosnjë e Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.

Për më tepër, emetimet e SO₂ u rritën në nivel rajonal, ndërsa emetimet e pluhurit dhe NO_x u ulën vetëm me një sasi të papërfillshme.

Ndotja me SO₂ nga termocentralet e qymyrit të përfshira në NERP ishte 5,7 herë më shumë nga vlera e lejuar, krahasuar me 5,6 në vitin 2022. Ndotja nga pluhuri ishte 1,75 herë më shumë nga vlera e lejuar, krahasuar me 1,8 herë në vitin 2022; ndotja me NO_x ishte 1,3 herë më shumë nga vlera e lejuar, krahasuar me një tejkalim të lehtë në vitin 2022. Kjo e fundit ndodhi për faktin se çdo vit vlerat kufitare të NO_x ishin gjithnjë e më strikte, si dhe mungesës së zvogëlimit të emetimeve.

Duke marrë parasysh që Sekretariati i Komunitetit Energjetik ka hapur raste për të gjitha shkeljet, ndërsa CBAM ka mundësi të përshpejtojë ndalimin e qymyrit në rajon, në ndërkohë nevojitet më shumë presion, si brenda vendit ashtu edhe nga institucionet e BE. Kjo është një çështje që ka të bëjë si me shëndetin e njeriut, ashtu edhe me sundimin e ligjit.

Tashmë është humbur shumë kohë dhe ekziston një rrezik serioz i heqjes së paplanifikuar të qymyrit nga përdorimi, si shkak i dështimeve teknike dhe realiteteve ekonomike. Është veçanërisht shqetësuese që asnjë nga vendet e Ballkanit Perëndimor nuk i dorëzoi NECP-të e tyre përfundimtare Komunitetit Energjetik deri në afatin përfundimtar të qershorit 2024,¹⁴⁸ sepse një plan i qartë dhe vendimtar është vërtetë i domosdoshëm.

Rekomandime

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor më në fund duhet të fillojnë të qeverisin dhe të mos lejojnë që ndërmarrjet e energjisë të zgjasin pafundësisht afatet e tyre. Nevoja për të ulur ndotjen dhe për të rritur efikasitetin energjetik dhe format e qëndrueshme të energjisë së rinovueshme është më e madhe se kurrë.

Detyrimet e dhëna tashmë duhet të respektohen. Termocentralet që operojnë nën regjimin e funksionimit të afatizuar duhet të mbyllen menjëherë¹⁴⁹ dhe Maqedonia e Veriut duhet t'i përmbahet datës së saj të heqjes së qymyrit nga përdorimi në vitin dhe të dyfishojë përpjekjet për të qenë gati për këtë.

NECP-të përfundimtare dhe/ose të përditësuara të vendeve duhet të përmbajnë plane realiste për termocentralet tjera në vitet e ardhshme, bazuar në gjendjen e tyre reale teknike, nivelin e investimeve të nevojshme për t'i sjellë ato në përputhshmëri dhe disponueshmërinë e linjitet me cilësi të arsyeshme. Gjithashtu duhet të merren parasysh efektet e CBAM, pasi ato do të ndikojnë në funksionimin e termocentraleve me qymyr, sidomos në Bosnjë e Hercegovinë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut.¹⁵⁰ Në teori, vendet mund të përfitojnë përjashtime nëse plotësojnë kushte të tilla si bashkimi i tregjeve, futja e sistemeve të tregtimit të emetimeve dhe harmonizimi me legjislacionin përkatës të BE, por me progresin e bërë deri më tani, nuk mund të supozohet se kjo do të ndodhë.

Ndërkohë, orët e funksionimit të termocentraleve duhet të reduktohen për të mbajtur ndotjen në minimum. Me masa tjera afatshkurtëra dhe më sistematike mund të reduktohet edhe kërkesa, si ulja e humbjeve të shpërndarjes, izolimi i ndërtesave dhe përdorimi i pompave efikase të nxehtësisë për ngrohje në vend të ngrohësve me energji elektrike.

Urgjentisht duhet të sigurohet që njësitë e desulfurizimit të Ugljevik dhe Kostolac B të funksionojnë siç duhet. Investimet aktuale në pajisjet e desulfurizimit dhe kontrollit të pluhurit gjithashtu duhet të përshpejtohen aty ku do të kenë arsyeshmëri ekonomike, dhe ndërkohë, orët e punës duhet të reduktohen për të ulur barrën e ndotjes. Hedhja e mbeturinave dhe trajtimi i ujërave të zeza që rezultojnë nga desulfurizimi, duhet të zgjidhet me kohë dhe të jetë mirë e planifikuar, veçanërisht duke pasur parasysh rreziqet e larta të ndotjes së mjedisit jetësor në të ardhmen.

¹⁴⁸ Ose NECP të përditësuara si në rastin e Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Në fund të korrikut, Serbia miratoi NECP e saj, por deri më 29 korrik ende nuk ishte në dispozicion të publikut.

¹⁴⁹ Opcioni tjetër është që të bëhen riparime të mëdha në mënyrë që të jenë në vijë me vlerat kufitare të emetimit për termocentralet e reja siç parasheh Traktati i Komunitetit Energjetik, por jemi skeptik se kjo do të ishte ekonomikisht e arsyeshme në shumicën e rasteve.

¹⁵⁰ CEE Bankwatch Network, [The Western Balkan Power Sector - Between crisis and transition](#).

Megjithëse është e qartë se përgjegjësinë kryesore e kanë qeveritë e Ballkanit Perëndimor, institucionet e BE gjithashtu duhet të angazhohen më shumë. Nevojiten fonde për një tranzicion të drejtë të rajoneve të qymyrit dhe kalimin në ngrohje qendrore të qëndrueshme, ndërsa Traktati i Komunitetit Energjetik duhet të plotësohet me instrumente më të forta zbatuese, në të mirë të shëndetit të njeriut dhe mjedisit jetësor. Mekanizmi i tij për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duhet të forcohet për të përfshirë dënime bindëse për shkeljet e bëra.

Të gjitha qeverive të Ballkanit Perëndimor

- Të mbyllen menjëherë termocentralet me funksionim të afatizuar.
- Të zvogëlohen orët e funksionimit për termocentralet që nuk janë të harmonizuara, me qëllim që të respektojnë vlerat kufitare të emetimeve të përcaktuara në NERP, ndërsa pajisjet e kontrollit të ndotjes të funksionojnë ose termocentralet të mbyllen.
- Të publikohen Planet Kombëtare Energjetike dhe Klimatike me afate të qarta dhe transparente për mbylljen në faza të të gjitha termocentraleve të qymyrit dhe të përcaktohen datat e përafërta të heqjes së qymyrit dhe lëndëve djegëse fosile nga përdorimi. Planet duhet të marrin parasysh ndikimet e mundshme të çmimit të karbonit dhe/ose Mekanizmin e Rregullimit të Kufirit të Karbonit në vitet në vijim.
- Të rriten investimet në masat e efijencës së energjisë diellore, erës dhe për përmirësime të nevojshme në rrjetet ekzistuese, për të ulur humbjet dhe për të lejuar më shumë konekcione të burimeve të rinovueshme, si dhe përdorimin e pompave efikase të nxehtësisë për amvisëritë në vend të ngrohësve me energji elektrike, në mënyrë që të minimizohet nevoja për të mbajtur në funksion termocentralet e vjetra me qymyr. Të shtohet mbikëqyrja e mjedisit jetësor dhe pjesëmarrja e publikut për të minimizuar rezistencën që ka ndaj investimeve diellore, të erës dhe investimeve në rrjet.
- Të kushtohet vëmendje më e madhe planifikimit pjesëmarrës nga poshtë-lart për një tranzicion të drejtë në ato termocentrale dhe marrjes së vendimit se cilat miniera qymyri do të mbyllen të parat.

Autoriteteve të Bosnjës e Hercegovinës

- Së paku, të shqiptohen dënime bindëse ndaj EP BiH për funksionimin e paligjshëm të njësive Tuzla 4 dhe Kakanj 5, dhe gjithashtu për Tuzla 3, nëse ende funksionon.
- Të shqiptohen gjoba për PE BiH dhe ERS për shkelje të vlerave kufitare të NERP.
- Të anulohet menjëherë vendimi për zgjatjen e afatit të funksionimit të Tuzla 4 dhe Kakanj 5 dhe këto termocentrale të mbylljen.
- Të zvogëlohen menjëherë orët e funksionimit të të gjitha termocentraleve që shkelin vlerat kufitare individuale, të përcaktuara në NERP.
- Të ndërmerren veprime të mëtjshme për të reduktuar emetimet e pluhurit në Gacko, qoftë duke reduktuar orët e punës ose duke instaluar pajisje të reja, bazuar në një vlerësim real të jetëgjatësisë së mbetur të termocentralit.
- Të sigurohet menjëherë desulfurizim i vazhdueshëm në Ugljevik. Të ketë monitorim në kohë reale për të siguruar që desulfurizimi bëhet gjatë gjithë kohës.
- Të përshpejtohen investimet për desulfurizim në Kakanj 7 dhe Tuzla 6, për të cilat tashmë janë marrë vendime investimi, duke trajtuar në mënyrë adekuate akuzat për korrupsion.
- Në versionin përfundimtar të Planit të Integruar Energjetik dhe Klimatik, të caktohen datat sa më të hershme të mbylljes së Gacko, Kakanj 6 dhe Tuzla 5, pasi nuk ka gjasa të realizohen investime të konsiderueshme për kontrollin e ndotjes në këto njësi.
- Gjatë kryerjes së vlerësimeve të ndikimit mjedisor për masat e zvogëlimit të emetimeve, të sigurohet që studimet e EIA përmbajnë informacion të detajuar mbi teknologjinë që do të përdoret, çfarë duhet bërë me nënproduktet dhe rezultatet e pritshme në lidhje me zvogëlimin e emetimeve.
- Të anulohet ndërtimi i planifikuar i termocentraleve të reja me qymyr, Ugljevik III dhe Gacko II.

Autoriteteve të Kosovës

- Së paku, të shqiptohen dënime bindëse ndaj KEK-ut për shkeljen e kufijve të emetimeve të NERP.
- Të ulen urgjentisht emetimet e pluhurit nga Kosova B, fillimisht duke reduktuar orët e punës për të respektuar vlerat kufitare të termocentralit, derisa të përfundojë projekti i modernizimit. Të publikohen informacione të përditësuara mbi statusin e projektit.

- Të reduktohen orët e funksionimit të të gjitha njësive, për t'i sjellë ato në vijë me vlerat e tyre kufitare të përcaktuara në NERP dhe të fillohet mbyllja e Kosova A, njësi për njësi, pasi duket e pamundur që investimet e mëtejshme në kontrollin e ndotjes do të jenë ekonomikisht të justifikueshme.
- Në versionin final të Planit Kombëtar Energjetik dhe Klimatik, të caktohen datat sa më të hershme të mbylljes për Kosova A dhe Kosova B. Bazuar në këtë, të rivlerësohet fizibiliteti i investimeve të mëtejshme për kontrollin e ndotjes.
- Të përshpejtohen punimet e rikonstruksionit në Kosova B, për ta harmonizuar me vlerat e përcaktuara të emetimeve të pluhurit dhe NO_x.
- Të sigurohet përfundimi i shpejtë i projektit për përmirësimin e monitorimit të vazhdueshëm në Kosova B.

Autoriteteve të Malit të Zi

- Së paku, të shqiptohen gjopa bindëse ndaj EPCG për funksionimin e paligjshëm të termocentralit me qymyrin Pljevlja.¹⁵¹
- Të zhvillohet një plan B në rast se modernizimi i Pljevljes nuk shkon siç është planifikuar.
- Të përdoret procesi i NECP për të afatizuar një vit të caktuar për heqjen e qymyrit nga përdorimi, e që është më real se viti 2035.

Autoriteteve të Maqedonisë së Veriut

- Së paku, të shqiptohen dënime bindëse ndaj ESM për shkelje të vlerave kufitare të NERP.
- Të zyrtarizohet mbyllja e REK Oslomej dhe TEC Negotinë.
- Të shmangen vonesat e mëtejshme për heqjen e planifikuar të qymyrit nga përdorimi dhe mos hapen miniera të reja qymyri.
- Të adresohet urgjentisht mungesa e monitorimit në termocentralet e mëdha me djegie të brendshme.
- Të zvogëlohet ndotja me SO₂ dhe pluhur nga termocentrali i Manastirit, duke i mbajtur orët e punës në nivele sa më të ulëta të mundshme, në mënyrë që të jenë në vijë me vlerat kufitare deri në mbylljen e termocentralit.

Autoriteteve të Serbisë

- Së paku, të shqiptohen gjopa bindëse ndaj EPS për funksionimin e paligjshëm të termocentraleve me qymyr, Morava dhe Kolubara.
- Urgjentisht t'i jepen sqarime publikut pse emetimet e SO₂ nga Kostolac B vazhdojnë të jenë kaq të larta, pavarësisht nga instalimi i një njësie de-SO_x dhe çfarë bëhet për ta rregulluar këtë.
- Të publikohen të dhënat e emetimeve në kohë reale në internet.
- Njësia e re Kostolac B3 nuk duhet të fillojë operimet komerciale nëse nuk është në përputhje me standardet LCP BREF.¹⁵²
- Të sigurohet përfundimi në kohë dhe efektiv i projektit aktual për instalimin e pajisjeve të desulfurizimit në Nikola Tesla B1 dhe B2. Të sigurohet që trajtimi i ujërave të zeza dhe asgjësimi i vazhdueshëm i gipsit të jenë funksionale para përfundimit, për të shmangur vonesat në funksionimin e desulfurizimit pasi të ketë përfunduar projekti.
- Duke marrë parasysh që në termocentralet kryesore me qymyr të Serbisë janë përfunduar ose janë në zhvillim e sipër investimet në desulfurizim, fokusi për pjesën e mbetur të termocentraleve tani duhet të jetë në planifikimin për mbylljen dhe tranzicionin e drejtë të punëtorëve dhe rajoneve më të gjera, në varësi të termocentraleve.

¹⁵¹ Ndryshimet e Ligjit për emetime industriale në dhjetor të vitit 2022 nuk e bëjnë funksionimin e tij më pak të paligjshëm – për më shumë detale shih Raportin [Comply or Close](#) për vitin 2023.

¹⁵² Rekomandojmë mos vënien në funksion të këtij impianti për arsye klimatike, shëndetësore dhe ekonomike; rekomandimi i cekur rrjedh nga përmbajtja e këtij raporti.

Komunitetit Energjetik

- Sekretariati duhet të vazhdojë të ndihmojë Palët Kontraktuese në finalizimin e Planeve të tyre Kombëtare Energjetike dhe Klimatike, me rritjen e investimeve në format e qëndrueshme të energjisë së rinovueshme, përcaktimin e çmimeve të karbonit, heqjen dorë nga subvencionet e qymyrit dhe përgatitjen e një tranzicioni të drejtë.
- Duke pasur parasysh mungesën e përmirësimeve dhe shkeljen e vlerave të emetimit të oksideve të azotit në vitin 2023, i bëjmë thirrje Sekretariatit të nxjerrë një opinion të argumentuar për Serbinë në lidhje me shkeljet e saj të NERP dhe të finalizojë rastet e tjera aktuale të NERP dhe funksionimit të afatizuar.
- I bëjmë thirrje Komitetit Këshillues që të japë mendim për rastin Pljevlja dhe rastet e pazgjidhura të parapara me NERP.

Komisionit Evropian dhe shteteve-anëtare të BE

- Të mbështetet plotësimi i Traktatit të Komunitetit Energjetik për të siguruar ndëshkime bindëse në rastet e mospërputhjes.
- Të sigurohet financim shtesë dhe të dedikuar për një tranzicion të drejtë të rajoneve të qymyrit në Ballkanin Perëndimor.
- Të sigurohet që përjashtimet e mundshme nga CBAM sipas Nenit 2(7) të Rregullores në vendet e Ballkanit Perëndimor të zbatohen në mënyrë rigoroz.
- Të ndërprehet financimi për projektet që lidhen me ndërlidhësit e energjisë elektrike dhe projekte tjera që termocentraleve që nuk janë në përputhshmëri u mundësojnë shitjen e energjisë elektrike në BE.
- Të sigurohet që financat e BE dhe ato ndërkombëtare të mos mbështesin gazin, në mënyrë që të shmanget përdorimi i mëtejshëm i karburanteve fosile.

Shtojca 1

Materialet dhe metodologjia

Të dhënat për emetimet e termocentraleve me qymyr të Ballkanit Perëndimor u mbledhën nga [EIONET Central Data Repository](#). Të dhënat për vitin 2023 do të verifikohen nga Agjencia Evropiane e Mjedisit Jetësor brenda disa muajve të ardhshëm.

Ku ka qenë e mundur, kemi përdorur shifra të verifikuara të emetimeve nga Agjencia Evropiane e Mjedisit Jetësor për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2022, e për shkak të përditësimit, disa të dhëna mund të jenë ndryshe nga ato të cituara në raportet e mëparshme të Përmbaju ose Mbyll. Planet Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve që kemi përdorur janë dokumente zyrtare të publikuara nga secili prej vendeve. Vlerat e përgjithshme të nivelit të vendit të përdorur si referencë përfshijnë, në disa raste (p.sh. Serbia), vlerat kufitare të emetimeve nga objektet tjera që nuk janë termocentrale me qymyr (p.sh. rafineritë), gjë që shpjegon pse në ato raste vlerat kombëtare janë më të larta se shuma e vlerave individuale të termocentraleve me qymyr.

